



NURA: KRERËT E UÇK-së PO MBAHEN PADREJTËSISHT NË EMËR TË ASAJ QË QUHET DREJTËSI | FAQE 4-5



“Sot ka drejtësi selektive. Drejtësi asimetrike. Sot krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës po mbahen padrejtësisht në emër të asaj që quhet drejtësi. Sot ish-presidenti i Kosovës,

Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentari Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe shokët e tjerë të luftës, po vuajnë nga padrejtësitë që bëhen në emër të drejtësisë. Trupi ynë

si popull rënkon edhe nga plagët e tjera që u shkaktuan nga lufta e Kosovës”, ka thënë kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, në fjalimin e tij në 24-vjetorin e masakrës së Izbicës

KONJUFCA TAKON ESCOBARIN: NUK DO TË KETË ASOCIACION QË CENON SOVRANITETIN E KOSOVËS | FAQE 5



DIALOGU KOSOVË - SERBI VAZHDON JAVËN TJETËR NË NIVEL TË KRYENEGOCIATORËVE | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



KOSOVA BARAZON EDHE ME ANDORRËN | FAQE 6

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Britania dhe Polonia do të ndërtojnë fshatra të përkohshme në Ukrainë

LONDËR, 28 MARS - Britania e Madhe dhe Polonia do të ndërtojnë dy fshatra të përkohshme në perëndim dhe qendër të Ukrainës për t'u ofruar strehim atyre që janë detyruar të ikin nga shtëpitë e tyre si pasojë e luftës në Ukrainë.

Londra ka thënë se do të ndajë fonde prej 12.3 milionë dollarëve. Pothuajse 118 000 ukrainas janë strehuar nga familjet britanike në kuadër të përgjigjes qeveritare ndaj pushtimit rus në Ukrainë që ka nisur në shkurt të vitit 2022, mirëpo disa refugjatë janë duke e pasur shumë të vështirë të gjejnë shtëpi të përhershme.

Qeveria britanike ka thënë se fshatrat në Lviv, në perëndim të Ukrainës dhe në Poltava në qendër të Ukrainës, do të mund të strehojnë më shumë se 700 njerëz - një përqindje e miliona ukrainasve që janë shpërngulur,

apo janë larguar krejtësisht nga shteti. "Në vitin e kaluar (presidenti rus, Vladimir) Putin ka vazhduar t'i shënjestrojë shtëpitë civile dhe infrastrukturën, dhe populli ukrainas e ka paguar çmimin e rëndë", ka thënë ministri i Jashtëm britanik, James Cleverly, përmes një deklarate.

"Ky partneritet i ri Mbretëri e Bashkuar - Poloni do të ndihmojë që ukrainasit të kenë dritë, ngrohje dhe shtëpitë që u duhen aq shumë".

Presidenti rus, Putin, e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



Rikthehen linjat e transportit në Gjermani



BERLIN, 28 MARS - Linjat e transportit publik në Gjermani janë rifunksionalizuar në orët e para të së martës pas një greve masive të punëtorëve të transportit të hënën, që ka ndikuar në paralizim të shumë sektorëve.

Mijëra punëtorë të aeroporteve, hekurudhave dhe linjave të autobusëve e metrove kanë mbajtur grevën në kërkim të një

page më të mirë.

Në Aeroportin e Frankfurtit, më të madhin në Gjermani, të hënën nuk është ofruar asnjë shërbim për pasagjerë dhe trafiku ajror pothuajse është ndalur plotësisht. Pavarësisht se greva ka përfunduar në mesnatë, pasagjerët ende po përballesh me vonesa dhe anulime të fluturimeve dhe udhëtimeve të

tjera me trena në distancë të gjatë, ka thënë një zëdhënës për kompaninë kombëtare të hekurudhave "Deutsche Bahn".

Greva 24-orëshe është thirrur nga dy sindikatat më të mëdha të punëtorëve në Gjermani: Verdi dhe EVG. Ato kanë kërkuar paga më të mëdha për punëtorët në mënyrë që të përballesh me lehtë me nivelin e lartë të inflacionit.

Hungaria voton për anëtarësimin e Finlandës në NATO

BUDAPEST, 28 MARS - Parlamenti i Hungarisë ratifikoi aplikimin për anëtarësim të Finlandës në NATO, por ende nuk është votuar edhe për anëtarësimin e Suedisë në aleancën ushtarake.

Finlanda dhe Suedia kërkuar t'i bashkohen NATO-s vitin e kaluar, në përgjigje të pushtimit rus të Ukrainës. Por ky proces është penguar nga Turqia dhe Hungaria. Megjithatë aplikimi finlandez tashmë është miratuar, ai suedez është ende i bllokuar në parlamentin hungarez.

Projektligji për pranimin e Finlandës në NATO u miratua me 182 vota për dhe gjashtë kundër pasi u shty disa herë.

Hungaria mbetet i vetmi vend anëtar i NATO-s që, përveç

Turqisë, nuk ka miratuar ende aplikimin e Suedisë për t'iu bashkuar aleancës ushtarake perëndimore.

NATO-ja kërkon që të 30 shtetet t'i ratifikojnë aplikimet për anëtarësim me qëllim që të pranohen shtetet e tjera.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se u kishte kërkuar Turqisë dhe Hungarisë që t'i ratifikojnë të dyja kërkesat.

Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan tha javën e kaluar se Turqia do ta nisë procesin e ratifikimit të anëtarësimin të Finlandës në NATO, por jo edhe të Suedisë.

Ankaraja kundërshton pranimin e Suedisë, pasi thotë se strehon persona që i konsideron anëtarë të

organizatave terroriste.

Finlanda, Suedia dhe Turqia në qershorin e vitit të kaluar arritën një marrëveshje trepalëshe. Turqia shprehu frustrimin e saj lidhur me atë që e sheh si dështim të Suedisë për t'iu përmbytur zotimeve të marrëveshjes.

Ankaraja pezulloi negociatat me Suedinë pas një proteste të mbajtur në janar në Stokholm, ku para ndërtesës së Ambasadës turke u dogj një Kuran. Por, më 9 mars, dy shtetet rinisën bisedimet në Bruksel.

Erdogani tha se anëtarësimi i Stokholmit në aleancën ushtarake perëndimore do të varet drejtpërdrejt në masat që ndërmerren sa iu përket kërkesave turke lidhur me terrorizmin.



Bjellorusia thotë se pranoi armët bërthamore ruse për shkak të "presionit" perëndimor

MINSK, 28 MARS - Bjellorusia ka thënë të martën se është detyruar t'i pranojë armët bërthamore ruse për shkak të

presionit "të pashembullt" perëndimor. Megjithatë, Minsku ka insistuar se pranimi i tyre nuk i ka shkelur

marrëveshjet ndërkombëtare. Presidenti rus, Vladimir Putin, e ka prezantuar në fundjavë planin për dërgimin e armëve

bërthamore taktike në Bjellorusi. Ky vendim është dënuar ashpër nga Perëndimi.



Dialogu Kosovë - Serbi vazhdon javën tjetër në nivel të kryenegociatorëve

PRISHTINË, 28 MARS - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, ka bërë me dije se javën e ardhshme do të zhvillohet një takim në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi në nivel të kryenegociatorëve.

Kryenegociatori i Kosovës për këto takime është zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, ndërsa i Serbisë është udhëheqësi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković.

Në këtë takim është thënë se fokusi do të jetë në zbatimin e marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve për të cilën Kosova dhe Serbia kanë arritur pajtueshmëri më 27 shkurt si

dhe në aneksin e zbatimit, për të cilin palët janë pajtuar më 18 mars në Ohër të Maqedonisë së Veriut.

Stano është shprehur i kënaqur që, siç ka thënë ai, dialogu po bëhet më i popullarizuar në rajon dhe se po organizohen gjithnjë e më shumë takime. Ai ka deklaruar kështu duke iu referuar një propozimi të kryeministrit me mandat teknik të Malit të Zi, Dritan Abazović, që takimi i radhës në mes të Kosovës dhe Serbisë të zhvillohet në shtetin që drejton ai. "Na vjen mirë që dialogu po bëhet kaq i popullarizuar në rajon dhe gjithnjë e më shumë vende po ofrohen që të jenë mikpritës të tij.

Por le të shkojmë hap pas hapi. Dialogu është i bazuar në Bruksel dhe kemi arritur një hap shumë të rëndësishëm në Ohër pas arritjes së pajtueshmërisë në mes të presidentit të Serbisë dhe kryeministrit të Kosovës, ku ata u pajtuan edhe për marrëveshjen, edhe për aneksin e implementimit. Tash fokusi është në implementim", ka thënë ai.

Stano ka folur edhe për hapat që janë bërë pas takimit të Ohrit. "Kemi pasur takim në Këshillin e Punëve të Jashtme. Përfaqësuesi i Lartë [Josep Borrell] i njoftoi ministrat, pastaj ai ka informuar edhe partnerët e tjerë. Kemi pasur edhe Këshillin Evropian, ku liderët miratuan këtë dhe

porositën të dyja palët se duhet ta vazhdojnë implementim të shpejtë, me mirëbesim të obligimeve që kanë marrë mbi vete".

Stano ka paralajmëruar se brenda BE-së po punohet që të rinisë puna në adaptimin e kornizës negociuese me Serbinë, më saktësisht Kapitullin 35, dhe në mënyrë përkatëse edhe në rastin e Kosovës. "Dialogu si i tillë vazhdon. Do të ketë takime të tjera në nivel të lartë për të cilat do të njoftojmë kur të jetë e përshtatshme. Ajo që mund të them në këtë moment është se një takim i kryenegociatorëve do të zhvillohet javën që vjen në Bruksel. Kryenegociatorët nga të

dyja palët janë ftuar nga lehtësuesi i dialogut që të vijnë në Bruksel dhe të avancojnë përpara me hapat e parë për implementimin e gjithë asaj që kanë rënë dakord", ka thënë Stano.

Sipas kryediplomatit të BE-së, Borell, Kosova dhe Serbia kanë arritur pajtueshmëri në Ohër për aneksin e zbatimit të Marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve mes dy vendeve, ndonëse nuk e kanë nënshkruar asnjë dokument. Por, në BE kanë përsëritur se edhe pa nënshkrim këto dokumente konsiderohen obliguese për të dyja palët dhe se të gjitha përpjekjet për t'i vënë në pikëpyetje janë të kota.



Greçia nuk ndryshon qëndrim karshi Kosovës

PRISHTINË, 28 MARS - Qëndrimi i Greçisë lidhur me shtetësinë e Kosovës mbetet i pandryshuar, ka deklaruar presidentja greke Katerina Sakellariopoulou gjatë vizitës në Beograd më 28 mars.

Greçia është një prej pesë shteteve të Bashkimit Evropian që ende nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. "Gjithmonë ka presione në nivel diplomatik, por kjo nuk ka ndikuar në pozicionin tonë. Ne kemi konsistencë në politikë", tha Sakellariopoulou pas takimit të saj me presidentin serb Aleksandër Vuçiq.

Ajo gjithashtu theksoi se Greçia e mirëpret Aneksin për zbatimin e marrëveshjes drejt normalizimit midis Kosovës dhe Serbisë që u arrit në Ohër më 18 mars me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. "Greçia është e gatshme t'i mbështesë Beogradin dhe Prishtinën për zbatimin e marrëveshjes", shtoi ajo.

Kosova dhe Serbia para takimit të Ohrit më 27 shkurt në Bruksel u

pajtuan për marrëveshjen drejt normalizimit të raporteve, apo siç njihet ndryshe edhe si propozimi evropian për normalizim.

Sakellariopoulou shtoi se Greçia mbështet dialogun që synon normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve dhe gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme. "Perspektiva evropiane e Ballkanit Perëndimor është një prioritet strategjik i Greçisë. Anëtarësimi në Bashkimin Evropian do të ofrojë paqe dhe siguri dhe do ta parandalojë ndikimin e vendeve të treta në Ballkanin Perëndimor", theksoi ajo.

Ndërkaq, Vuçiqi deklaroi se me homologen greke bisedoi për marrëveshjen e arritur në Ohër si dhe për lidhjen e infrastrukturës dhe stabilitetin energjetik.

Vuçiqi tha se është rënë dakord për "blerjen e sasive të caktuara të gazit të lëngshëm" nga Greçia. "Tema e takimit ishte ndërlidhja



e mëtejshme energjetike, ku Serbia shprehu interesim për blerjen e gazit të lëngshëm nga [porti grek] Aleksandropolis", tha Vuçiqi dhe shtoi se tubacioni i gazit me Bullgarinë duhet të përfundojë në tetor, i cili do ta lehtësojë dërgimin e gazit.

Vuçiqi falënderoi presidenten greke për mbështetjen e Serbisë në rrugën e saj evropiane, duke shtuar se është me interes jetik që Serbia të vazhdojë të kërkojë një zgjidhje kompromisi në bisedimet me Kosovën dhe ta përshejtojë rrugën drejt

Bashkimit Evropian.

Ai shtoi se shteti do t'i vazhdojë reformat dhe do të punojë për përmirësimin e të drejtave të njeriut si dhe "do të zbatojë gjithçka që është rënë dakord". "Serbia është në rrugën evropiane dhe dëshiron të bëhet anëtare e BE-së, por kjo nuk varet vetëm nga ne. Pjesa më e madhe e asaj që pritet nga Serbia ka të bëjë me dialogun me Prishtinën", tha Vuçiq.

Marrëveshja e Ohrit në mes të Kosovës dhe Serbisë synon t'i çojë palët drejt normalizimit të plotë të raporteve. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje është lidhur me përpunimin e të dyja shteteve drejt integriteteve evropiane.

Përveç Greçisë, edhe Sllovakia, Qiproja, Spanja dhe Rumania janë pesë shtetet anëtare të BE-së që ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Athina, megjithatë, ka shprehur mbështetjen për liberalizimin e vizave për Kosovën.



Nura: Krerët e UÇK-së po mbahen padrejtësisht në emër të asaj që quhet drejtësi

“Sot ka drejtësi selektive. Drejtësi asimetrike. Sot krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës po mbahen padrejtësisht në emër të asaj që quhet drejtësi. Sot ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentari Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe shokët e tjerë të luftës, po vuajnë nga padrejtësitë që bëhen në emër të drejtësisë. Trupi ynë si popull rënkon edhe nga plagët e tjera që u shkaktuan nga lufta e Kosovës”, ka thënë kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, në fjalimin e tij në 24-vjetorin e masakrës së Izbicës

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

SKENDERAJ, 28 MARS - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, në fjalën e tij në tubimin përkujtimor në nderim të 147 civilëve të vrarë, në 24-vjetorin e masakrës së Izbicës, ka thënë se sot krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës po mbahen padrejtësisht në emër të asaj që quhet drejtësi. Ai thotë se si popull nuk kemi si të mos jemi të shqetësuar për padrejtësitë që po na shkaktohen. Nura ka theksuar se ndaj krerëve të UÇK-së sot ka drejtësi selektive. “Sot ka drejtësi selektive. Drejtësi asimetrike. Sot krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës po mbahen padrejtësisht në emër të asaj që quhet drejtësi. Sot ish-presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, ish-

kryeparlamentari Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe shokët e tjerë të luftës po vuajnë nga padrejtësitë që bëhen në emër të drejtësisë. Trupi ynë si popull rënkon edhe nga plagët e tjera që u shkaktuan nga lufta e Kosovës. Mbi 100 familje të komunës sonë sot vuajnë mungesën e më të dashurve të tyre, fati i të cilëve sot e 24 vjet më parë nuk është zbardhur”, ka thënë Fadil Nura. Duke folur për masakrën e Izbicës, Nura ka thënë se kjo masakër është kujtim i pavdekshëm, përveç të tjerëve, edhe për Çlirimtar Behramin, viktimë më e re e kësaj masakre, jeta e të cilit vetëm sa kishte nisur. “Vetëm pesë javë nga jeta e tij e nisur mes krismave të kësaj ane dhe luftës së pabarabartë mes një populli liridashës dhe një agresori të neveritshëm, Çlirimtari

është viktimë më e re e Masakrës së Izbicës”, ka thënë kreu i Skenderajt, duke shtuar se pagëzimi i tij është domethënës, për një popull që po vuante shtypjen, vrasjet, barbarizmin dhe çdo veprim tjetër të llahtarshëm. Nura ka thënë se në këtë përvjetor

dhe në çdo shënim tjetër të kujtimit për dëshmorët, martirët dhe civilët e vrarë për lirinë e Kosovës, nuk kemi si të mos jemi të shqetësuar për padrejtësitë që po na shkaktohen. Në përvjetor të kësaj masakre ishin të pranishëm edhe generali Sami

Lushtaku, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, deputetë të Kuvendit të Kosovës, gjeneralë të luftës, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, familjarë, drejtorë të ekzekutivit, asamblistë dhe qytetarë të shumtë.



BSPK-ja mbështet “Marshin për drejtësi” më 2 prill

PRISHTINË, 28 MARS - Dy ideatorët e iniciativës “Liria ka emër”, Eliza Hoxha dhe Ismail Tasholli, kanë takuar të martën kryetarin e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Atdhe Hykolli. Gjatë këtij takimi, Hoxha dhe Tasholli e kanë njoftuar

kryetarin e BSPK-së për marshin e drejtësisë i cili do të mbahet më 2 prill në Prishtinë. Hoxha dhe Tasholli kanë kërkuar mbështetjen dhe pjesëmarrjen edhe të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës në këtë marsh solidarizimi dhe përkrahje për

ish-krerët e UÇK-së të cilët po mbahen në Hagë. Në anën tjetër, kryetari i BSPK-së, Atdhe Hykolli, u ka ofruar të gjithë mbështetjen e nevojshme për këtë marsh. “Marshi për drejtësi” do të mbahet më 2 prill në sheshin “Zahir Pajaziti” në Prishtinë.

Kurti dhe Osmani: Edhe Izbica është një ndër dëshmitë e shumta që shteti serb ka kryer gjenocid

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

SKENDERAJ, 28 MARS - Presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Albin Kurti kanë bërë homazhe të martën në Kompleksin Memorial në Izbicë.

Presidentja Osmani ka thënë se sot në Izbicë përkujtojnë 147 të vrarë nga forcat gjenocidale serbe. "Kjo ka qenë një ndër masakrat më të tmerrshme të Serbisë, të shtetit gjenocidal serb, ndaj popullit shqiptar. Krimi nuk përfundoi me vrasjen dhe masakrimin e qytetarëve tanë në Izbicë, por u dyfishua atëherë kur forcat serbe zhvarrosën të vrarët dhe i rivarrosën në varreza masive nëpër vende të ndryshme në Serbi dhe në Kosovë. Trupat e tyre u gjetën vite më pas, duke përfshirë edhe gjashtëmuajshen Dafinën, që e tregon mizorinë e krimeve që Serbia i ka kryer në Kosovë", ka thënë presidentja Osmani.

Presidentja ka shtuar se edhe Izbica është një ndër dëshmitë e shumta që shteti serb ka kryer gjenocid. "Edhe Izbica është një ndër dëshmitë e shumta që shteti serb ka kryer gjenocid dhe qëllimin e kishte që ta shfaroste popullin shqiptar. Prandaj, edhe sot këtu e ndajmë dhimbjen me të gjitha familjet që

kanë humbur më të dashurit e tyre. Dhimbja e tyre është dhimbje e Kosovës. Liria u bë e mundshme shkak i të gjitha këtyre viktimitave, shkak i luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe sakrificës së gjithë popullit tonë. Prandaj, lavdia për të gjithë ata që dhanë jetën për liri do të jetë e përgjeshme", ka theksuar Osmani. Pranë memorialit të të vrarëve kryeministri Kurti tha se kjo masakër ndodhet në aktakuzat e gjashtë kërëve të lartë shtetërorë politike, policore e ushtarake të Serbisë dhe është dëshmi e gjenocidit të Serbisë. "Ata janë rrëmbyer si njerëz, si shqiptarë e më pastaj, pas pushkatimit, u janë rrëmbyer edhe kufomat, janë dërguar në Serbi dhe në fund janë zhvarrosur prej atje, por jo që të gjithë, meqenëse 6 ende nuk dihet se ku janë", u shpreh kryeministri Kurti.

Ai tha "nuk do ta harrojmë kurrë gjenocidin e Serbisë dhe se do të angazhohemi përjetë e vazhdimisht si institucione dhe si qytetarë për drejtësinë, për viktimitat dhe familjet e tyre".

Kryeministri Kurti kujtoi edhe Mustafë Dragajn, i mbijetuar i masakrës, i cili pati dëshmuar kundër Slobodan Millosheviqit në Tribunalin e Hagës.



Konjufca takon Escobarin: Nuk do të ketë Asociacion që cenon sovranitetin e Kosovës



WASHINGTON, 28 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, po qëndron për vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në kuadër të kësaj vizite ai është takuar me përfaqësuesin special për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar.

Konjufca ka treguar se me Escobarin kanë diskutuar për zhvillimet aktuale politike në vend

dhe rajon, për procesin e dialogut dhe marrëveshjen e Ohrit, si dhe për hapat e mëtejme për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë. "Sot, në kuadër të vizitës sime zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i shoqëruar nga ambasadori i Republikës së Kosovës në Washington DC, Ilir Dugolli dhe shefi i Stafit, Ilir Kërçeli, takova

zëvendësndihmës-sekretarin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, njëherësh përfaqësues special për Ballkanin Perëndimor, z. Gabriel Escobar. Në takimin përmbajtjesor me z. Escobar diskutuam për zhvillimet aktuale politike në vend dhe rajon, për procesin e dialogut dhe marrëveshjen e Ohrit, si dhe për hapat e mëtejme për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërmjet

Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Ritheksuam qëndrimin e shtetit të Kosovës, por edhe garantimin e Departamentit të Shtetit, se nuk mund të formohet kurrfarë asociacioni apo ndonjë mekanizëm tjetër që cenon sovranitetin, pavarësinë, integritetin territorial dhe rendin kushtetues të Republikës së Kosovës", ka theksuar Konjufca.

Ai ka bërë me dije se me Escobarin shprehën pikëpamje të njëjta që të vazhdojnë të punojnë së bashku për agjendën e përbashkët të anëtarësimit të Kosovës në strukturat euroatlantike dhe organizata ndërkombëtare, po ashtu edhe për avancimin e marrëdhënieve dypalëshe në mes të Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Komuna e Prishtinës nis aksionin kundër taksive ilegale dhe autobusëve ndërurbanë

PRISHTINË, 28 MARS - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se Drejtoria e Inspeksionit është duke punuar për lirimin e komunikacionit nga parkimi dhe qarkullimi i taksive ilegale dhe autobusëve ndërurbanë

nëpër kryeqytet. “Aksioni i inspektorëve të rendit komunal, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, po bëhet për ta evituar ngarkesën e cila po krijohet nga këta operatorë, me qëllim që ata ta kenë Stacionin e Autobusëve

si pikë të vetme ndalese dhe ta paguajnë taksën e përcaktuar nga kjo ndërmarrje. Kontrollat e tilla do të vazhdojnë deri në vetëdijesimin e plotë. Rregullat duhet të zbatohen nga të gjithë!”, thënë Rama.



Lladrovci bën homazhe në përvjetorin e 24-t të rënies së heroit Milazim Kiqina



DRENAS, 28 MARS - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, së bashku me bashkëpunëtorë, ka bërë homazhe në Semetishtë të Suharekës në përvjetorin 24-t të rënies në altarin e lirisë të heroit nga Baica e Drenasit, Milazim Kiqina. “Heronjtë janë frymëzim për të tjerët, janë simbol i guximit, dinjitetit dhe përkushtimit. Ata shërbejnë si shembuj frymëzues për të tjerët sesi duhet mbrojtur atdheu, janë kulminacioni i frymëzimit deri në vetëflijim. Ata nuk heshtin

kundrejt padrejtësive me të cilat përballen. Pra, janë shembuj të jashtëzakonshëm të përkushtimit dhe sakrificës për kauzën e lirisë dhe të drejtave të popullit të tyre. Lavdi gjithë dëshmorëve të kombit! Ne po plakemi, ata po mbesin të rinj”, ka theksuar Lladrovci. Gjatë kësaj ceremonie, nën përkujdesjen e kryetarit të komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, u promovua edhe libri në nderim të heroit, me titullin “Simbol çlirimtari” i autorit Beqir Kiqina.

Po punohet edhe jashtë orarit të punës për t'i ndihmuar bujqit malishevas

MALISHEVË, 28 MARS - Komuna e Malishevës, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi, është duke punuar edhe jashtë orarit të punës, me qëllim që bujqit të mund të aplikojnë për subvencione që jep Ministria e Bujqësisë. Për këtë qëllim, me kërkesë të drejtorit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Sylë Dukolli, dhe me miratim të kryetarit të komunës, Ekrem Kastrati, stafi i kësaj drejtorie po punon edhe jashtë orarit të punës,

edhe të shtunave, për t'u ofruar shërbime të gjithë bujqve që duan të aplikojnë. “Detyrë dhe qëllim yni është që sa më shumë të mbështesim dhe t'u ofrojmë shërbime bujqve të komunës sonë në mënyrë që të kenë mundësi të aplikojnë për subvencione. Ne jemi në shërbim të të gjithë qytetarëve, prandaj edhe stafi i drejtorisë do të punojë jashtë orarit dhe të shtunave vetëm që t'u ofrojë sa më shumë shërbime bujqve”, ka

thënë drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Sylë Dukolli. Drejtoria për Bujqësi, me qëllim të ofrimit të shërbimeve për bujqit, gjatë periudhës sa zgjatë aplikimi për subvencione nga ana e Ministrisë së Bujqësisë do të punojë nga ora 08:00 deri në orën 18:00, çdo ditë pune, edhe të shtunave. Deri më tani shërbime kanë marrë rreth 750 bujq, ndërsa numri pritet të jetë shumë më i madh këtë vit.



Bulliqi dhe kryetari i Linzit vizituan fabrikën e tekstilit dhe të kërpudhave

PODUJEVË, 28 MARS - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, bashkë me kryetarin e Linzit, Klaus Luger, i cili po qëndron në vizitë zyrtare në komunën e Podujevës, vizituan fabrikën e tekstilit “S//Sprint” dhe fabrikën e kërpudhave “Agro-Peti”. Qëllimi i vizitës ishte që delegacioni austriak të shohë

për së afërmi shërbimet që ofrojnë për treg këto industri, duke parë nga afër potencialin, dinamikën e punës dhe inovacionet që po zhvillohen në prodhimin e tekstilit dhe të kërpudhave. Drejtuesit e fabrikës “S//Sprint” e njoftuan delegacionin për kapacitetet e fabrikës, prodhimin,

numrin e punëtorëve etj. Pas kësaj ata vizituan fabrikën e kërpudhave “Agro-Peti” e cila merret me grumbullimin, prodhimin, përpunimin dhe eksportimin e kërpudhave, bimëve mjekuese aromatike dhe frutave të imëta, kurse informata më të hollësishme për fabrikën dha pronari Petrit Shabani.

Vazhdon largimi i deponive në komunën e Mitrovicës

MITROVICË, 28 MARS - Komuna e Mitrovicës po angazhohet të ketë një ambient sa më të pastër në tërë territorin e saj, andaj për këtë Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit dhe Pyjeve po angazhohet ta bëjë largimin e dhjetëra deponive ilegale në vende të

ndryshme. Për këtë aksion të largimit të mbeturinave dhe pastrimin e hapësirave, në të cilat kanë qenë të krijuara deponitë, është përkujdesur KRM “Uniteti”.

Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit dhe Pyjeve, Egzon Sadiku, ka bërë

thirrje që qytetarët të përkujdesen që mbeturinat t'i hedhin në vendet adekuate, në të kundërtën për të gjithë personat e papërgjegjshëm që shkaktojnë ndotje të ambientit do të shqiptohen gjoja sipas ligjit.



Reagim i KMDLNj-së

“Marrëveshja” e Ohrit, shpresë apo zhgënjim për familjarët e të pagjeturve

Me ndërmjetësimin - presionin ndërkombëtar në Ohër u arrit një “marrëveshje” e panëshkruar, siç thuhet, midis Prishtinës dhe Beogradit ku, ndër të tjera është përfshirë edhe çështja e të pagjeturve që ka qenë kërkesë e vazhdueshme e familjarëve dhe organizatave që përfaqësojnë të pagjeturit. Edhe më parë, nën ndërmjetësimin e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar kishte takime midis delegacioneve të Kosovës dhe Serbisë për çështjen e të pagjeturve por se nuk kishte lëvizje pozitive për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur. Thuaja kjo çështje kishte vendnumëruar dhe angazhimi për fatin e të pagjeturve mbeti kryesisht të familjarët, qoftë si përpjekje individuale, qoftë përmes organizimit në shoqata për të pagjetur të cilat nuk e kishin as për së afërmi përkrahjen institucionale për të zhvilluar aktivitete që, në vendet normale janë përgjegjësi e shtetit dhe organeve të ndjekjes.

Që nga fillimi procesi për të pagjetur u trajtua gabimisht, në vend se të trajtohet si çështje e të drejtave të njeriut, ky proces u politizua duke u keq-përdorur për qëllime politike, sidomos gjatë fushatave zgjedhore dhe momenteve të ndjeshme siç ishte formimi apo mbijetesa e qeverive. Pastaj, gabimi i madh që u bë në fillim ishte ndarja e të pagjeturve sipas kriterit etnik



sikur edhe kërkesa e informatave për të pagjeturit, gjithashtu sipas parimit etnik dhe jo si e drejtë e pakundërshtueshme e të drejtave të njeriut për zbardhjen e fatit për të gjithë personat e pagjetur pavarësisht përkatësisë etnike besimit, moshës, gjinisë, bindjeve politike, përkatësisë kulturore etj. Bashkësia ndërkombëtare ka qenë penguesi më i madh i zbardhjes së fatit të personave të pagjetur duke iu përshtatur oportunitetit politik; mos ndërmerrë asnjë veprim që e rrezikon paqen e brishtë në Kosovë dhe të mos hidhërohet Serbia. Madje kanë bërë eksperimente me mbetjet mortore, ende pa u identifikuar nga një kriminel mjekoligjorë, Pablo Hoze Barajabar që i vodhi mostrat. Në vend se ndërkombëtarët të bonin presion menjëherë pas përfundimit të luftës, çështjen e të pagjeturve e

konservuan duke ia lënë harresës së kohës.

Edhe kjo “marrëveshje” e Ohrit, çështjen e të pagjeturve nuk e trajton, as me urgjencë e as me seriozitet por e ka si pjesë thuaja fakultative të kësaj “marrëveshjeje”.

Kjo “marrëveshje” mund dhe edhe do t’i rrisë shpresat e familjarëve që me ankth presin ndonjë informatë për anëtarët e familjes që janë në listën e të pagjeturve mirëpo aty nuk ka asgjë detyruese, as sa i përket afatit e as masave ndaj atyre që nuk pranojnë të japin informata për fatin e të pagjeturve e që, sipas KMDLNj-së zbehë skajshmërisht mundësitë për zgjidhjen e kësaj çështjeje shumë të ndjeshme për familjarët e të pagjeturve në Kosovë dhe në Serbi.

Aktualisht janë mbi 1600 persona që janë në listën e të pagjeturve për të cilët nuk ka asnjë informatë

për fatin e tyre e që kjo listë për një kohë të gjatë nuk ka pësuar asnjë ndryshim. Pala kosovare me të drejtë kërkon informata nga Serbia për fatin e të pagjeturve kosovarë, shqiptarë dhe joserbë sikur që edhe pala serbe kërkon, gjithashtu me të drejtë informata për të zhdukurit serbë numri i të cilëve nuk është i vogël. Këtu edhe qëndron problemi sepse askush nuk ofron informata për të pagjeturit nëse i nënshtrohet përgjegjësisë penale për këtë.

Në kohën kur po flitet për njëfarë normalizimi midis Kosovës dhe Serbisë, është mashtrim të pritët që me seriozitet do të ketë qasje për zbardhje të fatit të personave të pagjetur, si nga palët bashkëbiseduese e në veçanti jo nga bashkësia ndërkombëtare. Kapitulli për të pagjeturit i kësaj “marrëveshjeje” të imponuar, nuk i është bërë i ditur opinionit e sidomos jo nëse është i përfshirë në aneks dhe nëse është i afatizuar apo kushtëzuar me sanksione ndaj palës jobashkëpunuese. Në raportet jobashkëpunuese siç janë midis Kosovës dhe Serbisë dhe me rolin e strucit të bashkësisë ndërkombëtare, KMDLNj nuk beson se do të ketë lëvizje cilësore në zbardhjen e fatit të personave të pagjetur dhe se bartësit e posteve institucionale nuk do të duhej të risin këto shpresa për faktin se thuaja asgjë nuk është në duart e tyre, nuk i pyet askush për

asgjë dhe se nuk mund t’i adresojnë kërkesat vetëm në një adresë pa qenë në gjendje që edhe vet të ofrojnë informacione për të pagjeturit. KMDLNj nuk bënë asnjë dallim midis personave të pagjetur, as në baza etnike, moshore, gjinore, besimit, bindjeve politike, kulturave që i përkasin por kërkon që kjo çështje të trajtohet ekskluzivisht nga pozita e të drejtave të njeriut përkatësisht sipas parimit të universalitetit të këtyre të drejtave që e garantojnë Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës. KMDLNj kërkon drejtësi për familjet e të pagjeturve dhe përgjegjësi për ata që kanë planifikuar, nuk e kanë penguar apo kanë zbatuar aksionet policore dhe ushtarake e që për pasojë kanë zhdukjen e mbi 1600 personave që aktualisht janë në listën e të pagjeturve.

Në fund, KMDLNj e shtron një pyetje, fillimisht nga aspekti i të drejtave të njeriut, atij ligjor por edhe moral; pse do të duhej të kishte përparësi absolute përmes kushtëzimit dhe shantazhimit formimi i Asociacionit të Komunave Serbe në Kosovë, para një zgjidhjeje të një çështjeje krejtësisht njerëzore siç është zbardhje e fatit të personave të pagjetur e që është interes i të gjithëve!

Inspektorati Policor vitin e kaluar ka rekomanduar suspendimin e 164 punonjësve policorë

Kryeshefi ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës, Kushtrim Hodaj, ka bërë me dije të martën se institucioni që drejton ka rekomanduar suspendimin e 164 punonjësve policorë. Hodaj ka thënë se janë trajtuar rreth 1 700 ankesa të qytetarëve, duke theksuar se gjatë vitit të kaluar janë hetuar 257 zyrtarë policorë, ndërsa janë arrestuar 100

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 MARS - Kryeshefi ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës, Kushtrim Hodaj, ka raportuar të martën në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes lidhur me raportin vjetor të punës për vitin 2022. Përkritazi me këtë raport, Hodaj ka paraqitur aktivitetet me të cilat ka qenë i angazhuar Inspektorati. Ai ka vlerësuar se ka ngritje të cilësisë së shërbimit, duke përmendur faktin se hetuesit në këtë institucion kanë treguar nivel më të lartë të profesionalizmit, duke vlerësuar se ka pasur rritje të numrit të aktiviteteve. Sipas Hodajt, fokusi gjatë këtij viti ka

qenë luftimi i korrupsionit brenda policisë.

Në vijim ai foli për trajtimin dhe adresimin e ankesave. “I kemi trajtuar me kujdes ankesat e qytetarëve dhe se 34 për qind të tyre i kemi drejtuar në hetime”, ka thënë ai, duke sqaruar se kanë rekomanduar suspendimin e 164 punonjësve policorë. Ai ka thënë se janë trajtuar rreth 1 700 ankesa të qytetarëve, duke paraqitur hollësi rreth 12 inspektimeve të realizuara gjatë atij viti.

Sipas tij, gjatë vitit të kaluar janë hetuar 257 zyrtarë policorë, ndërsa janë arrestuar 100.

Ai ka folur edhe për bashkëpunimin ndërinstitucional, trajnimet, marrëveshjet e bashkëpunimit si dhe për



aktivitete të tjera.

Pas shpalesjes së këtij raporti, Bekë Berisha ka kërkuar sqarime rreth konkurseve. Me theks të veçantë ai ka kërkuar të dhëna lidhur me konkursin për policë të Njësisë së Mbrojtjes së Afërt. Ai ka thënë se i kanë kaluar të gjitha procedurat, ndërsa nuk janë pranuar. Për këtë, Hodaj ka treguar se kanë zhvilluar

një hetim.

Disa nga anëtarë të Komisionit i kanë përgëzuar përfaqësuesit e IPK-së për angazhimin, punën dhe profesionalizmin, duke i vlerësuar inkurajuese rezultatet e vitit të kaluar nga ky institucion. Është thënë, po ashtu, se hetimi me profesionalizëm është ndihma më e madhe që IPK-ja mund t’ia

bëjë policisë. E disa nga ta kanë paraqitur edhe shqetësime të shumta dhe pyetje. Mes të tjerash, u bë me dije se ka shumë ankesa për korrupsion nga hetimet dhe se ka padrejtësi dhe humbje të dëshmimeve, si dhe moszbardhje të hetimeve, duke kërkuar reflektim për këto dhe për të gjitha çështjet që u ngritën.

Petrit Selimi me fakte tronditëse për Gjykatën Speciale



PRISHTINË, 28 MARS - Ish-ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Petrit Selimi përmes profilit të tij në "Twitter", ka renditur fakte tronditëse për Gjykatën Speciale. Selimi ka shpjeguar se 15 vjet më parë, një politikan zviceran Dick Marty doli vullnetar për të shkruar një raport mbi "trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë". "BE-ja dhe ShBA-ja i bënë presion Kosovës që të krijojë një gjykatë speciale 'për të pastruar retë nga lufta çlirimtare'. Gjykata do të kushtojë minimalisht 1 miliard euro. Dick Marty kishte një histori tiradesh anti-amerikane dhe ai ishte autor i një raporti tjetër të CoE-së për anët e errëta të CIA-s (duke thënë gabimisht baza e KFOR-it në Bondsteel, Kosovë ishte një anë e errët CIA-s)", ka shkruar Selimi. Ai më tej ka shkruar se Dick Marty kishte edhe histori të deklaratave kundër pavarësisë së Kosovës në peizazhin politik zviceran. Sipas tij, nuk ka asnjë aktakuzë të vërtetë dhe asnjë provë në asnjë nga procedurat për ndonjë "nxjerrje organesh". Sipas ish-ministrit të Jashtëm të Kosovës e gjithë historia ishte e çuditshme, pasi aeroporti i Tiranës, "nyja e transportit të organeve" ishte nën kontrollin e NATO-s! "Është i njëjti pretendim që Rusia bën tani për

ushtrinë e Ukrainës. Presidenti i Kosovës, i cili dikur ka qenë një udhëheqës politik i ushtrisë guerile, i është publikuar aktakuza pikërisht në orën kur ai ishte brenda aeroplanit duke udhëtuar për në ShBA për të nënshkruar marrëveshjen e paqes të mbështetur nga Trump me Serbinë. Koha shumë e çuditshme", ka thënë ai. Selimi që ka shumë ndjekës në "Twitter" ka shkruar se aktakuza ndaj Thaçit nuk ka asgjë për "nxjerrje organesh". Gjykata u shty sipas tij nga Perëndimi, duke argumentuar "për të penguar Rusinë të përdorë KS të OKB-së për të krijuar një gjykatë të OKB-së". Ai ka shkruar se deputetëve të Kosovës u bënë presion nga administrata e Obamës për të krijuar një lloj organi që është brenda kushtetutës së Kosovës, por me seli në Hagë. "Megjithatë, ky organ u tregua se e refuzoi Kosovën. Ky organ asnjëherë nuk e ka përdorur emrin kushtetues të Republikës së Kosovës, asnjëherë nuk e përdor flamurin e Kosovës. Gjykata është mono-etnike pasi ndërkombëtarët që punojnë atje nuk dhanë asnjë indikacion për të ndjekur penalisht ndonjë krim nga qeveria serbe, agresori aktual në luftën e Kosovës", ka shkruar ai. Selimi nuk është ndalur me kaq.

Ai ka shkruar se Udhëzimet e Dakarit për krijimin e gjykatave hibride, që synojnë të ofrojnë një pasqyrë strategjike se si të krijohen gjykata hibride, këmbëngulin në pronësinë lokale të proceseve të tilla. Sipas tij, ka zero pronësi të Kosovës mbi këtë Gjykatë, zero përgjegjësi nga gjykata, zero qartësi se kur do të përfundojë gjykimi ndonjëherë. Ky organ i çuditshëm sipas Selimit ka paditur 2 ish-kryetarë parlamentari, 1 ish-president dhe dy ish-deputetë dhe po i kushton taksapaguesve të BE-së shumë më tepër se i gjithë buxheti i të gjithë policisë kufitare të BE-së FRONTEX. "Disa vende si Norvegjia pushuan së kontributi plotësisht. Investime fantastike, kthime të dyshimta. Sipas FHP-së së mirënjohur me bazë në Beograd, e cila hulumton krimet e luftës, në totaliteti të të gjitha gjykatave të OKB-së, EULEX-it, gjykatave lokale, ka pasur më shumë gjykime përfundimtare kundër guerilëve shqiptarë se sa zyrtarë serbë për krime lufte në Kosovë. Kjo është tepër fyese dhe joetike. Disproporcioni i padrejtë i rëndë ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të shpallur fajtorë për krime lufte është thjesht i papranueshëm. Serbia pushoi së akuzuari këdo dhe kriminelët e luftës si Guri, përgjegjës për

vrasjen e qytetarëve amerikano-shqiptarë, vëllezërit Bytyçi, tani janë zyrtarë të partisë në pushtet", ka shkruar ai. Selimi më tej ka shtruar pyetje se pse kosovarët e krijuan këtë kimerë gjyqësore? "Për shkak të presionit të jashtëzakonshëm nga Perëndimi (deputetëve të veçantë u bë presion çdo ditë për ta votuar në parlament) dhe premtimi se kjo do t'i japë fund të gjitha spekulimeve mbi 'nxjerrjen e organeve'. Por çfarë morëm? Një perpetum celular i vetë kënaqshëm. Sondazhet e opinionit në Kosovë janë të qarta. Shumica dërrmuese e njerëzve nuk e pëlqejnë këtë trup dhe as e perceptojnë atë si të padrejtë. Edhe akademikët e drejtësisë pajtohen se gjykata 'nuk i përgjigjet nevojave të popullit kosovar', sepse 'kërkon drejtësi për krimet e vetëm njërës palë'. Një aspekt kontrovers i këtij organi është mbështetja e madhe në të dhënat e prokurorëve serbë. Prokurorët serbë janë përfaqësues të shtetit serb", ka shkruar Selimi. Petrit Selimi më tej ka përmendur edhe rastin "Panda", duke theksuar se shteti serb ishte përgjegjës për gjenocidin dhe operacionet e flamurit të rremë (vrasja e fëmijëve serbë për të cilën u fajësua UÇK). "Rasti i

kafenesë Panda është i tmerrshëm. Dhe duke folur për misione vrasëse me flamur të rremë nga qeveria Serbisë, e dini se çfarë ndodhi me Dick Marty, i cili filloi të gjithë këtë biznes të keq "nxjerrjen e organeve"? Ai tani është nën mbrojtjen e policisë zvicerane për shkak se u zbulua një plan që "elementë të policisë sekrete serbe" planifikonin të vrisnin Martin, në mënyrë që të fajësohen Hashim Thaçi dhe UÇK-ja. Një kthesë tepër e çuditshme, por brenda aftësive të shërbimit sekret serb", ka theksuar Selimi. Ai ka shkruar se Hashim Thaçi është quajtur nga presidenti Biden si "George Washington of Kosova". "Meritat e tij për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës janë të mëdha. Ky organ refuzon ta lirojë atë të paktën në arrest shtëpiak, edhe në vendet e treta që ofronin lehtësira. Kjo është arsyeja pse shumë njerëz, përfshirë unë dhe familjarët, do të protestojnë këtë të diel në 'Marshimin për Drejtësi'. Jo kundër drejtësisë por për drejtësi për të gjitha viktimat. Rrëfimi në aktakuza bazohet në narrativen Serbe për luftën. Gjykata monoetnike nuk është drejtësi. Është një perversitet i drejtësisë", ka shkruar ish-ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Petrit Selimi.

Fehmi Mehmeti përmbylli mandatin e guvernatorit të BQK-së, numëron sukseset

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 MARS - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka mbajtur konferencën e fundit në pozitën e të parit të BQK-së. Ai ka thënë se pavarësisht prej vështirësive me të cilat është ballafaquar, BQK-ja ka arritur t'i zbatojë objektivat, duke siguruar një sistem financiar të qëndrueshëm, sidomos në vitet e fundit, ku arriti t'i përballojë me sukses krizat e shkaktuara nga pandemia Covid-19, edhe nga agresioni rus në Ukrainë, por edhe të jetë një nga shtyllat kryesore të mbështetjes për bizneset dhe individët dhe të ekonomisë së vendit. "Sistemi financiar në vend gjatë kësaj periudhe pesëvjeçare është karakterizuar me zhvillime pozitive dhe rritje të vazhdueshme në të gjithë indikatorët e saj. Nën udhëheqjen time si guvernator BQK-ja ka arritur të sigurojë një sistem financiar të qëndrueshëm, stabil, të mirëkapitalizuar dhe likuid. Një qëndrim i ngjashëm lidhur me sistemin financiar në vend mund të evidentohet edhe në raportet e institucioneve financiare ndërkombëtare, si: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Raporti i Komisionit Evropian, Banka Qendrore Evropiane, Departamenti Amerikan i Shtetit dhe shumë institucione



të tjera. Gjithashtu, performanca e përgjithshme financiare e BQK-së gjatë kësaj periudhe ka qenë shumë e kënaqshme, duke realizuar të ardhura gjithëpërfshirëse gjatë gjithë pesëvjeçarit të qeverisjes", ka deklaruar guvernatori Mehmeti. Ai ka thënë se sektori bankar gjatë kësaj periudhe ka shënuar rritje të vazhdueshme si në numrin e institucioneve, njëkohësisht edhe në rritje të aktivitetit të këtij sektori. "Nga dhjetë banka sa ishin në fund vitit 2018 deri në tetor të vitit 2022, ky numër u rrit në dymbëdhjetë duke iu shtuar edhe dy institucione financiare me aktivitet bankar. Ky sektor nga tetori 2018 deri në vitin 2022 ka shënuar rritje. Në fund

të vitit 2022 arriti në 6.76 miliardë euro, nga 4.18 miliardë sa ishin në fund të vitit 2018", ka thënë ai. Mehmeti ka theksuar se rritja e asetëve të sektorit bankar rezultoi me rritjen e portofolit kreditor që në dhjetor të vitit 2022 arriti vlerën prej 4.35 miliardë eurove, nga 2.75 miliardë sa ishin në vitin 2018. "Sektori bankar gjatë gjithë kësaj periudhe, përkundër rritjes së vazhdueshme dyshifrore të kreditimit, ka vazhduar të jetë i mirëkapitalizuar dhe likuid. Raporti i likuiditetit të sektorit bankar vazhdon të jetë i lartë dhe mbi kërkesat rregullative të BQK-së. Përveç sektorit të bankave, edhe IMF-IFJB-të shënuan performancë stabile,

ku në fund të vitit 2022 vlera e asetëve të këtij sektori ishte 387.7 milionë euro, një rritje prej 146.1 milionë eurosh, apo 60.5 për qind krahasuar me vitin 2018. Rritja stabile dhe cilësore e kredive konfirmohet edhe nga niveli i kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë që në fund të vitit 2022 ishte 1.8 për qind, më ulët krahasuar me vitin 2018 kur ishte 2.2%. Në konferencën për medie guvernatori ka përmendur vendimet për tërheqjen e licencave të institucioneve "IuteCredit" dhe "Monego". Ai tha se gjatë viteve 2019-2022 injektimi shtesë i kapitalit ishte në shumën prej 20.3 milionë eurosh, kurse gjatë periudhës pesëvjeçare Fondet Pensionale

në Kosovë kanë shënuar rritje të vazhdueshme, ku nga 1.65 miliard euro sa ishin në fund të vitit 2017, deri në muajin dhjetor të vitit 2022 fondet pensionale kanë arritur vlerën prej 2.42 miliardë eurosh. "Është e rëndësishme të theksohet se përkundër tërheqjes së 10-përqindëshit të fondeve pensionale gjatë vitit 2020, si rezultat i aprovimit të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, në vlerë rreth 200 milionë euro, fondet pensionale kanë vazhduar trendin rritës edhe gjatë viteve vijuese, përkatesisht gjatë vitit 2021 dhe 2022. Megjithatë, për shkak të lëvizjeve të pafavorshme në tregjet ndërkombëtare, si rezultat i agresionit rus në Ukrainë, gjatë vitit 2022 sektori pensional shënoi rënie të kthimeve në investime, ku rënia e këtyre investimeve gjatë vitit 2022 ishte në vlerë rreth 120 milionë euro. Megjithatë, me përmirësimin e tregjeve financiare, vlerësohet se edhe rënia e vlerës së këtyre investimeve do të rikuperohet, ndërkohë që kontributet e reja pensionale gjatë vitit 2022 shënuan vlerën prej rreth 242 milionë eurosh", ka thënë Mehmeti, duke shtuar se gjatë kësaj periudhe BQK-ja ka vazhduar angazhimin e saj edhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve të shërbimeve financiare, ku deri në nëntorin e vitit të kaluar janë shqyrtuar 810 ankesa.

Kosova, mundësi të mira punësimi për punëtorët sezonalë në bujqësi



PRISHTINË, 28 MARS - Kosova ka mundësi të mira punësimi për punëtorët sezonalë në sektorin e bujqësisë, thuhet në raportin e "Democracy Plus", paraqitur në konferencën "Mundësi më të mira punësimi për punëtorët sezonalë në Kosovë". Aty është theksuar se në bazën ligjore mungon definimi i punëtorëve sezonalë si dhe rregullimi i statusit të kësaj kategorie në legjislacion. Gjithashtu,

mungojnë të dhënat rreth numrit të tyre që angazhohen gjatë vitit në sektorin e bujqësisë. "Vende pune të drejta, mjedis më të mirë biznesi dhe rritje e të ardhurave nga taksat për të mirën publike - Gjermania mbështet përpjekjet ambicioze të vendeve të Ballkanit Perëndimor për ta trajtuar çështjen e ekonomisë joformale. Formalizimi dhe

ulja e papunësisë do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurimit social të qytetarëve, në veçanti të punëtorëve sezonalë", është shprehur zëvendësambasadori gjerman në Kosovë, Matthias Conrad. Ndërsa Leunora Ahmeti nga Ministria e Financave ka theksuar se në Ligjin e ri të Punës do të parashihet edhe rregullimi i kategorisë së

punëtorëve sezonalë si dhe krijimi i një regjistri elektronik për regjistrimin e tyre. Në realizimin e kësaj të fundit edhe përfaqësuesit e Agjencisë Tatimore të Kosovës (ATK) shprehën gatishmërinë për të kontribuar, po ashtu u konstatua se në kuadër të Ligjit të ri për Administrimin e Procedurave Tatimore do të kërkohet që punëdhënësi para se ta nënshkruajë kontratën

me punëmarrësin do të detyrohet ta regjistrojë atë. Të pranishmit theksuan nevojën e një fushate sensibilizuese për informimin e bizneseve dhe qytetarëve për rëndësinë e regjistrimit të këtyre punëtorëve. Po ashtu, u konstatua rëndësia e përfshirjes së punëtorëve sezonalë në legjislacion si dhe përfshirja e tyre në kontributet pensionale dhe sigurimet shëndetësore.

Nëntë udhëheqësit e lashtë që e ndryshuan rrjedhën e historisë



Analet e historisë janë të mbushura me tregime mbi udhëheqës të mëdhenj që kanë lënë gjurmë në këtë botë, duke diktuar e ngjarjeve njerëzore përmes veprimeve, vendimeve dhe vizioneve të tyre. Nga pushtuesit që ndërtuan perandori të mëdha tek shtetarët që sollën paqe dhe stabilitet në kombet e tyre, këta udhëheqës të lashtë ishin arkitektët e kohës së tyre, duke lënë pas një trashëgimi që ka rezistuar për shekuj me radhë. Ja cilët janë 9 prej tyre:

1. Aleksandri i Madh, Mbreti i Maqedonisë

I lindur në vitin 356 Para Krishtit Aleksandri lindi nga Filipi II Mbreti i Maqedonisë dhe Olimpias, një princeshë nga Epiri. U ngjiti në fron në moshën 20 vjeçare pas vrasjes së të atit. Krijoi një aleancë me mbretëritë e tjera greke, dhe nisi luftën ndaj armikut të vjetër të Greqisë, Persisë. Gjatë 10 viteve të ardhshme, Aleksandri pushtoi pjesën më të madhe të botës së njohur. Pasi mundi persët dhe pushtoi kryeqytetin e tyre, Persepolis, nisi të realizonte ëndrrën e tij, një perandori kozmopolite që shtrihej nga lindja në perëndim. Por nuk e realizoi dot pasi vdiq në moshën 33-vjeçare nga një sëmundje misterioze. Gjithsesi mbretërimi i tij solli përhapjen e kulturës greke në mbarë botën. Sukseset e tij ndikuan në rrjedhën e filozofisë, shkencës dhe letërsisë për shekujt e ardhshëm.

2. Jul Çezari dhe vdekja e Republikës Romake

I lindur në vitin 100 Para Krishtit, Jul Çezari është një nga figurat më të famshme dhe më mendikim në historinë e lashtë romake. Ai luajti një rol kryesor në ngjarjet që çuan në rënien e Republikës Romake dhe lindjen e Perandorisë Romake.

Çezari ishte para së gjithash një udhëheqës i madh ushtarak. Karriera e tij përfshinte një seri fitoresh mahnitëse, si pushtimin e Galisë (Franca e sotme) dhe humbjen e armikut të tij, Pompeit (një udhëheqës ushtarak rival). Ai luajti një rol kyç në formimin e Triumviratit të Parë, një aleancë e fuqishme politike që përbëhej nga ai, Pompeudhe Kراسi.

Kur aleanca u shpërbë, Çezari u kthye në Romë në vitin 44 dhe u bë një diktator i përhershëm. Por sundimi i tij nuk zgjati shumë. Më 15 mars të po atij viti, u vra nga një grup senatorësh që kishin frikë se Çezari ishte bërë shumë i fuqishëm. Vdekja e tij e zhyti Romën në krizë. Pas një serie luftëra civile, në krye të perandorisë u ngjiti Oktaviani (djali i birësuar i Çezarit).

3. August Çezari, Perandori i Parë i Romës

U ngjiti në pushtet pas vrasjes së Jul Çezarit. Në luftërat civile që pasuan ai mundi rivalin e tij kryesor, Mark Antoni, dhe u bë sundimtari i padiskutueshëm i Romës. E konsolidoi pozitën e tij duke siguruar besnikërinë e ushtrisë, reformuar sistemin ligjor dhe vendosur një sistem klientësh që siguronte mbështetjen e elitave. Këto reforma e bënë Romën një perandori e qëndrueshme dhe e begatë, të cilën bota nuk e kishte parë kurrë më parë. Augusti drejtoi një program të madh ndërtimesh që e transformuan qytetin e Romës në kryeqytetin kulturor të botës antike. Sistemi i tij i qeverisjes dhe i administratës u bë modeli për sundimin e perandorëve të mëvonshëm.

4. Qin Shi Huang, njeriu i parë që bashkoi Kinën

I lindur në vitin 259 Para Erës Sonë, Qin Shi Huang u ngjiti në fronin e

shtetit Qin në moshën 13-vjeçare, pas vdekjes së babait të tij. Ai nisi të konsolidonte pushtetin e tij duke i shtypur fraksionet rivale brenda mbretërisë dhe krijuar një burokraci të centralizuar. Më pas filloi të pushtojë 6 mbretëritë e tjera dhe u bë perandori i parë që bashkoi Kinën.

Ai shfuqizoi feudalizmin dhe i zëvendësoi zyrtarët që trashëgonin postin me ata që e fitonin atë sipas meritave. Më pas drejtoi një seri projektesh ambicioze si Muri i Madh i Kinës dhe një kanal që lidhte lumenjtë Jance dhe Perl. Po ashtu ndërtoi shumë rrugë, reformoi prerjen e monedhave dhe e rishpërndau tek fshatarët pjesën më të madhe të tokës së mbretërisë.

Por nga tjetër, ishte një lider brutal që shtypte me dhunë të gjitha format e mospajtit. Ishte përgjegjës për djegien e librave, ekzekutimin e dijetarëve, dhe u bë gjithnjë e më i fiksuar pas mbajtjes së pushtetit. Pinte mërkur për të jetuar përgjithmonë, dhe ndërtoi ushtrinë e terrakotave me qëllim që t'i shërbente atij përgjithmonë.

5. Ashoka i Madh: Promovuesi i Paqes dhe tolerancës në Indi

Sundoi mbi Perandorinë Mauria në vitet 268-232 Para Krishtit. E nisi mbretërimin e tij me një periudhë brutale pushtimesh, që e zgjeruan territorin e Maurias në pjesën më të madhe të nën-kontinentit Indian. Ajo periudhë kulmoi me fitoren e tij në Betejës e Kalingas në vitin 261.

Por numri i madh i të vrarëve e nxiti Ashokan të reflektonte thellë. Ai përqafoi menjëherë Budizmin dhe hoqi dorë nga dhuna dhe agresioni. Zbatoi një sërë politikash që synonin promovimin e harmonisë sociale dhe kulturore si dhe mësimet të Budës. Dekretet e tij përfshinin

tolerancën ndaj feve të tjera, promovimin e mirëqenies sociale dhe vënien e theksit tek mospërdorimi i dhunës dhe dhembshuria.

6. Kleopatra VII, faraonia e fundit e Egjiptit

E famshme për bukurinë dhe zgjuarsinë e saj në politikë, ajo sundoi në vitet 51-30 Para Krishtit. Mbretërimi i saj u karakterizua nga politika e saj e jashtme ambicioze, e cila u fokusua tek një aleance strategjike me Jul Çezarin e Romës. Të dy u takuan në vitin 48, u dashuruan dhe sollën në jetë një djalë, Çezarionin. Kur u vra Çezari, Kleopatra lidhi në aleancë me Mark Antonin. Por ky u mund nga Oktavian Augusti në vitin 30. Kleopatra dhe Antoni kryen vetëvrasje. Egjipti u pushtua nga Augusti dhe u shndërrua në një provincë të Romës.

7. Xhengiz Khan: Themeluesi i Perandorisë Mongole

Lindi në vitin 1162, dhe në fillim njihet me emrin Temuxhin. Më vonë u bë themeluesi i Perandorisë Mongole, perandorisë më të madhe që ka parë ndonjëherë bota. Këtë e arriti duke bashkuar disa fise mongole nën udhëheqjen e tij, dhe përmes pushtimeve që patën sukses falë strategjive të tij të shkëlqyera. Nën drejtimin e tij, ushtria mongole u bë e famshme për shpejtësinë e rrefeshme, disiplinën e rreptë dhe brutalitetin. Por veç kësaj, ai ishte i njohur edhe për tolerancën e tij fetare dhe mbështetjen ndaj tregtisë. Kur vdiq në vitin 1227, perandoria u nda midis djemve dhe nipërve të tij. Perandoria e tij pati një ndikim të madh duke lehtësuar përhapjen e kulturës,

fesë dhe teknologjisë në Azi dhe Evropë.

8. Hatshepsut, Faraoneshae dytë grua

Hatshepsut ishte gruaja, vajza dhe motra e një mbreti. Por Egjipti kishte ligje dhe tradita të rrepta që e ndalonin sundimin e grave. Ndaj për t'u ngjitur në front Hatshepsut përdori dinakërinë e saj politike, prejardhjen mbretërore dhe ndikimin fetar. Pasi mori pushtetin nisi zbatimin e projekteve të mëdha ndërtimore që synonin legjitimimin e sundimit të saj. Asnjë sundimtar para saj, nuk zbatoi aq shumë projekte ndërtimore sa ajo. Për të paguar për to, riktheu rrugët e vjetra tregtare dhe kreu disa pushtime në shtetet fqinje.

9. Budica, mbretëresha luftëtare

Ishte mbretëresha e fisit kelt Icenii, e famshme për udhëheqjen e popullit të saj kundër romakëve. Kur vdiq bashkëshorti, ai dorëzoi mbretërinë e tij të vogël Romës me shpresënse ajo do t'i lejonte popullit të tij një formë pavarësie. Por romakët e shtypën brutalisht popullsinë kelte.

Kjo sjellje e frymëzoi Budicën të udhëheqë rebelimin e popullit të saj Icenii dhe fqinjëve të tyre kundër Romës. Ushtritë e saj pushtuan Kolçesterin dhe shkatërruan Legjionin XIX. Ushtria e saj përparoi duke plaçkitur vendbanimet romake, dhe duke i detyruar zyrtarët romakë të arratiseshin në Londinium (Londra e sotme). Fatkeqësisht, sukcesi i saj ishte jetëshkurtër. Romakët u hakmorën në një betejë në periferi të Londrës. Budica refuzoi të tërhiqej. Ajo i udhëhoqi rebelët e saj në betejë dhe vdiq gjatë betejës ose diku më pas. / ancient origins – bota.al

AJAZ EMINI - Ditar (V)

NJË JETË KUSHTUAR ATDHEUT

Nga kjo pozitë edhe lidhjet satelitore nuk punonin si duhet sepse edhe kapiteni më kishte premtuar se do të më bëjë të mundur bisedën me telefonin e tij satelitor që të kontaktojë Shahadijen për ditëlindjen e sajë. Rreth 12:30 pas mesnate filloi një zhurmë prej së largu e që për çdo sekondë po na afrohej gjithnjë e më afër. Ishin disa helikopter Apache që po vinin drejt nesh, të cilët u afruan dhe filluan të sillen mbi ne. Nuk m'u durua dhe nga gëzimi e kureshtja e zgjova vozitësin i cili më porositi që ta zgjojë nëse kemi ndonjë ndryshim para se t'ia fusë gjumit. Pas disa minutash u ndëgjua edhe më shumë zhurma e grupit tjetër të helikopterëve Apache AH-64 të cilët erdhën krejtësisht mbi ne, por pa kurrëfarë dritash që zakonisht natën i kishin të dhezura. Meqenëse nata ishte me një ndriçim të mrekullueshëm të hënës edhe ishte e kthjellët dhe kur u ofruan po dukeshin shumë mirë, qartazi po duke u sjellë mbi kokat tona. Kapiteni ishte zgjuar pakë më herët edhe u largua drejt grupit komandues, dhe pas disa minutash pas largimit të tij tani sapo kthehej. U afrua edhe më tha se ende nuk ka gjë, dhe sa po e shof nuk kemi për të guajtur as sonte siç na ndodhi edhe disa herë më parë. Pas një kohe na erdhi lajmi nga shtabi i përgjithshëm dhe tani u bë publike se edhe sonte nuk do të ketë kurrëfarë sulmi nga njësjia jonë. Me të ndëgjuar këtë lajm, që të gjithë ushtarët që ishin për rreth të gatshëm për akcion mbetën të dëshpëruar dhe të zhgënjyer. Ata për menjëherë sikurse të ishin sinkronizuar, filluan t'i bien burive të automjeteve në shenjë dëshpërimi dhe pakënaqësie. I binin borive edhe për t'i dhënë shenjë rojeve ushtarake për rreth neve që t'i lëshojnë pozicionet e tyre të rojes, të cilët mbrenda një kohe të shkurtër filluan që të largohen. Filluan të largohen sepse gjithçka për rreth kishin pasë bllokuar. Pas disa minutave edhe ne me të gjithë kolonën e automjeteve ushtarake filluam të tërhiqemi. Edhe kësaj here pozicioni ynë i ri ishte që të pozicionohemi diku jo shumë largë në fushën e Laçit. Në mëngjesin e hershëm nga Radio BBC ndëgjua një lajm të hidhur se njëri nga helikopterët tanë Apache AH-64 qenka rrëzuar ngase kishte pasë problem teknik, dhe për shkak të relievit të keq malor ku po manovronin diku afër kufirit me Kosovën. Edhe në këtë aksident paskemi dy viktimat e para të Ushtrisë Amerikane, këta ishin edhe viktimat e para ushtarake të NATO's që nga fillimi i kampanjës ajrore në luftën kundër forcave paramilitaro-ushtarake serbe. Ky helikopter Apache AH-64 sigurisht se do të ketë qenë ndonjëri prej atyre që mbrëmë erdhën dhe po sillshin mbi ne, atje ku ishim të pozicionuar për sulm. Ndoshta edhe sulmi ynë mundë që të jetë shtyrë nga shkaku i këtij aksidenti.



23 Nëntor 1999, Sojevë /Kosovë, takimi im i parë me Sekretaren e SHBA's Zonjën Madeleine Albright në Kampin ushtarak Amerikan "Bondsteel"

Edhe sot mbante kohë e mirë, por disi koha ishte e mërzhitshme dhe nuk po kalonte dot. Në sytë e secilit ushtar vërehej njëfarë pikëllimi, sigurisht se ishte nga lajmi i aksidentit të kolegëve në helikopterët Apache AH-64 të cilët ishin kolegë nga baza jonë, si dhe dëshpërimi nga dështimi i sulmit. Nga lajmet më të reja të ditës së sotme kuptuam se Presidenti Clinton pasi se ta vizitojë Shtabin e NATO's në Bruksel, po planifikonte që të vijë e t'i vizitojë edhe refugjatët shqiptarë të dëbuar dhe maltretuar nga Kosova prej armikut fashist serb.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Aviacioni i NATO's gjatë ditës së sotme kishte kryer 72 operacione kundër forcave serbe. Në Kosovë u qëlluan 21 topa artilerike, 30 mortaja, 4 tanke, 10 autoblanda, 8 artileri anti ajrore si dhe automjetet e tjera ushtarake serbe. Gjithashtu u sulmuan edhe depot e municionit në Novi Pazar, Boljevac dhe Kurshumli, depoja e karburantit në Somobor, treni me cisternë karburanti në Leskovc, shtabi i MUP'it në Kula Milicia, aeroporti në Ponikve, poligoni i ushtrimeve në Çuprija, riley i radios në Rudnik, radio stacionet në Serbobran, Pirot dhe Kapaonik. Gjatë ditës së sotme Presidenti Amerikan Clinton vizitoi qendrën e NATO's ku takoi sekretarin Solana për çka i siguroi se këtë mision do t'a çojë deri në fund. Bullgaria tani ishte pajtuar edhe për lejimin e hapësirës ajrore për tu shfrytëzuar nga forcat e NATO's në kampanjën kundër regjimit të Millosheviqit.

E enjte 6 maj 1999

Aty nga ora 2:30 u tërhoqem nga kjo pikë strategjike i tërë konvoji i

gjatë ushtarak që kishim, tani filluam lëvizjen në drejtim të Laçit. Që të gjithë ishim të dëshpëruar që nuk na u lejua të shfrytëzojmë momentin kryesor, që të shkatërronim agresionin ushtarak serb. Raketat që kishim me ne ishin raketa që kishin në shenjë caqet serbe në një largësi deri në 300 km., që don të thotë se kishin në kontroll të tërë Kosovën, si edhe mundë të arriheshin shumë lehtë edhe caqe mbrenda Serbisë. Në krye të këtij aksioni ishte i caktuar Kapiteni Bernardoni i baterisë "Charlie", i cili kishte një eksperiencë të madhe dhe shumë të suksesshme në sulmet me Lancuesit Raketor MLRS. Ai kishte qenë pjesëmarrës i suksesshëm gjatë luftës kundër Presidentit Sadam Huseinit në Irak. Vazhduam rrugën më tutje dhe vonë gjatë natës u ndalëm dhe parkuam diku në fushën e Laçit, edhe ashtu të ulur në karriget e automjeteve ia dhamë gjumit deri herët në mëngjes deri me fillimin e lindjes së diellit. Mëngjesi ishte shumë i bukur por i freskët.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë ditës së sotme forcat e NATO's sulmuan një numër të madhë të forcave serbe mbrenda Kosovës, ata sulmuan pjesët artilerike, postin komandues, bateritë raketore tokë-ajër, konvojën ushtarak në afërsi të Prizrenit, autoblandat në jug të Gjakovës si dhe qëlluan më së paku 7 tanke. Gjithashtu u sulmuan edhe shumë pika strategjike mbrenda Serbisë. Mbrëmë u sulmua riley i radios në Kopaonik dhe Novi Pazar, si dhe fabrika e derivateve të karburantëve në Somobor, Prahovo dhe Nish. Usulmua edhe ura në Uzhiçë, fabrika e municionit në Paninje

dhe Kacak, si dhe aeroporti në Ponikvë.

Jamie Shea njoftoi mediat sot dhe tha: "I jemi mirënjohës që më në fund u lejua që Rugova të largohet për në Itali, si dhe gëzohemi që ai është larguar me tërë familjen e tij. Gjithashtu shpresojmë se ai do të jetë i lirë që në të ardhmen të vijë dhe të bisedojmë me të, dhe të shohim edhe pozicionin e tij."

E premte 7 maj 1999

Edhe sot mbajti kohë e bukur, e nxehtë edhe me diell. Gjatë ditës nuk patëm shumë obligime, përveçse ndonjë herë kur vinte ndonjë ushtarë për të kërkuar ndihmën time për ndonjë mosmarrëveshje me popullatën lokale atje ku ishim për momentin, kur ato donin të kalonin rrugën për të shkuar në shtëpitë e tyre. Ata të cilët kishin shtëpitë mbrenda perimetrit ku ndodheshim ne, i lejonim që të shkojnë në shtëpitë e tyre, e kurse të tjerët nuk lejoheshin. Ishin të detyruar që të prisnin sepse rruga ishte e bllokuar për shkak të kalibrimeve të Lancuesve Raketorë MLRS. Dikur pas dite derisa ne po mirreshim me kalibrimin e Lancuesve Raketorë MLRS, si zakonishtë më kurioz ishin fëmijët që vinin që të na shikonin se ç'po bënim aty. Shumica e qytetarëve mbeteshin disi të habitur kur më ndëgjonin se i flisja në gjuhën shqipe, edhe pse e kisha mbiemrin e shkruar në helmët dhe uniformën ushtarake me mbiemrin tim Emin. Atyre nuk iu besohej se mundë që të kishte edhe shqiptarë në mesin e ushtrisë amerikane. Deri sa po bisedoja me fëmijët, një ushtar erdhi më kërkoi që të shkojë për t'i ndihmuar atij. Ai kishte problem me një burrë shqiptar të moshës së mesme, i cili po donte të vazhdojë rrugën e tij me makinë pa lejen e ushtarit edhe

pse e kishim bllokuar atë rrugë. E kishim bllokuar sepse po bënim kalibrimin e Lancuesve Raketorë MLRS. Shkova aty edhe iu afrova atij personit shqiptar edhe e përshëndeta në shqip: "Mirë dita zotëri". Kur më ndëgjoi se po i flisja shqip, disi filloi përnjëherë që ta ndryshojë qëndrimin. Filloi të trimërohet duke ngritë zërin dhe duke mu kërcënuar e duke më thënë: "Unë nuk kam kohë t'ju pres juve këtu tërë ditën, tani menjëherë do t'i hypë makinës dhe do të kalojë andej!" Unë i thashë i qetë: "Prit pakë ore burrë, sepse mbrenda disa minutash do t'ju lejojmë që të gjithëve, sepse ata atje gati sa s'e kanë kryer kalibrimin. Pastaj ju mundë që të vazhdoni rrugën tuaj". Ushitari që ishte afër meje ndëgjoi nga zëri atij burraleci se diçka nuk është në rregull dhe me pyeti: "Çka po të bërtet ty ky njeri?" I tregova drejtë se ky farë burraleci nuk po donë të presë që ta e kryejmë punën tonë të kalibrimit. Pa pritë aspak ushtari ia drejtoi pushkën burralecit trim edhe më tha: Thuaj këtijë: "Nanë q..., ta e shofim se si do të kalojë andej pa e kryer neve punën!". Për menjëherë burraleci i ndërroi fjalët, mu kthye mua edhe po më thotë: " Po ore vllaçko, kryene punën tuaj se unë pres. Nuk e kam problem, por si duket ju më keqkuptuat. Vazhdoni ju me punët tuaja". I thash: "Po ore vllaçko, nuk pate nevojë ta nënçmosh veten për asgjë, ky ishte vetëm një mësim për ty, Kalofshit ditë të mirë ore burrec!"

Edhe kjo ditë thujse kaloi, edhe ne kishim humbë të gjitha shpresat se do të sulmonim me raketa, edhe pse përsëri na u dha komanda që edhe sonte të jemi në gjendje të gatshmerisë. Aty nga ora 21:00 I nxorrëm Lancuesit Raketorë MLRS, dhe përsëri mbrenda një kohe krejtë të shkurtër zumë pozicionet e sulmit. Pas disa orësh përsëri nëpërmjet radiolidhjeve ushtarake na u tha se edhe kësaj here edhe kjo ishte veçse dhezje e thatë, që don të thotë pa municion, të veprohej sikurëse në sulmet e vërteta (operacionet ishin të kompjuterizuara nga Lancuesit Raketorë MLRS). Tani të gjithë ushtarët ishin të demoralizuar nga lajmi për mosveprim të sulmit raketor, të cilët nuk fshehnin dëshpërimin duke më thënë hapur se neve nuk kemi ardhë këtu në pushim. Ne kemi ardhë që të kryejmë punën dhe të kthehemi në bazat tona. Besimi i sulmit çdo ditë sa vinte e zbehej, pasi se tani veçse kishin filluar bisedime dhe më serioze në mes të palës serbe dhe përfaqësuesve të NATO's për një marrëveshje diplomatike me ndërmjetësues edhe nga pala ruse.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Sulmet e NATO's kryesisht ishin përqëndruar në sulme kundër tankeve, pozicioneve të artilerisë, posteve kufitare si dhe kundër pozicioneve të armëve kundër ajrore.

U sulmuan pikat strategjike, si bombardimi i pistës së aeroportit të Nishit në juglindje të Serbisë, si dhe afër stacionit të autobusëve të Nishit dhe depoja e karburantëve Jugpetrol. Sulmi në aeroportin e Nishit ishte bërë për shkak se aty është parë edhe një aeroplan luftarak si dhe një kamion ndihmës për mbrojtje kundërajrore. Në Nish u sulmua edhe ndërtesa e Shtabit të Përgjithshëm të Armatës Jugosllave, poashtu bombardime pati edhe në Beograd ku gabimisht u qëllua edhe Ambasada Kineze aty ku u vranë 3 dhe u plagosën 20 pjesëtarë të ambasadës. Në orën 21:46 të mbrëmjes bombarduesit B-2 sulmuan depon e armatimit në Beograd. Gjatë kësaj dite u bombardua edhe "Hotel Jugosllavia" për shkak se ky vend po shfrytëzohej si shtab i paramilitarëve të Tigrave të Arkanit, për shkak se hoteli tani një kohë të gjatë ishte në duart e Arkanit, dhe po përdorej si Qendër Komanduese për në Kosovë, si dhe qendrën policore të MUP'it. U sulmua edhe pika strategjike si depoja e karburantëve në Brohovo, Nish dhe Parane, depoja e municionit në Surdulicë, aeroportet në Seneca dhe Ponikive. Në Maqedoni për momentin ishin përqendru 13,000 ushtarë të NATO, të cilët po ndihmojnë shtetin Maqedon si dhe organizatat humanitare me ballafaqimin e mëse 200,000 refugjatëve shqiptarë të dëbuar nga Kosova...

E shtunë 8 maj 1999

Pas mesnatës, rreth orës 1:00 filluan lëvizjet për kthim në çadrat ushtarake të Rinasit. Ushtarët ishin të lodhur dhe të dëshpëruar, sepse për shumicën e tyre ishte ndoshta hera e parë për ta parë dhe përjetuar efektin e këtyre armëve artilerike. Këto ishin ndër armët më të përsosura të këtij lloji të Lancuesve Raketore MLRS. Në kampin ushtarak të Rinasit arritëm rreth orës 2:00 pas mesnate, ishte ditë me shi edhe balta kishte arritë nivelin e zakonshëm si nga ditët e para të miat në këtë kamp ushtarak. Ne ashtu të lodhur dhe rraskapitur, edhe pse kishim mbetë të pa larë e të pa pastruar për një javë, posa arritëm menjëherë shkuam edhe u futëm në thesin tonë të gjumit edhe fjetëm. Në mbrëmjen e së Premtes harrova të përshkruaj se në kompaninë apo njësinë tonë erdhi që ta zavendësojë kompania "Bravo" edhe disa pjesëtarë të kompanisë "Alpha". Ishte mjaftë interesante se për herë të parë kishim patur rastin që të mblidhen që të gjithë së bashku, kishte kaq shumë automjete dhe ushtarë, ku me to ishin edhe 24 Lancuesit Raketore MLRS. Që të gjithë në një vend. Aty dukej si një bazë e madhe ushtarake e përmasave të mëdha, ku secili që kalonte aty pari mbetej i mahnitur sepse i përngjante edhe dukej sikurëse të kishte filluar lufta edhe këndej kufirit kosovar. Dukej si të ishte gjendje lufte.

Gjatë ditës së sotme isha i lirë, bëra edhe pakë më tepër gjumë se zakonisht. Pastaj u zgjova dhe u pastrova edhe një herë si herave të mëparëshme me ujë të ftohtë, pasi se nuk munda të rregulloj

nxemësen e ujit që kinse tani na e kishin kishin vënduar. Kjo ishte diçka e ndërlikuar për të rregulluar për një fshatar Llojanas, dhe nuk kisha hasë dhe nuk dija se si punonte një aparat i tillë. Më vonë mblodha rrobat e pa lara për t'i bërë gati për në vendin e larjes, pasise ato i dërgonin në bazën tjetër ushtarake në Aeroportin e Shkupit. Këto i dërgonin në Maqedoni për t'i pastruar, sepse këtu në Rinas nuk kishim ujë të mjaftueshëm për ta kryer pastrimin që duhej. Për pastrimin e rrobeve ato zakonisht dërgoheshin në qendrat tjera ushtarake për rreth arenës ku ishim, dhe pas tre ditësh na u ktheheshin rrobe të pastruara dhe të hekurosura. Gjatë kësaj kohe më erdhi lajmi se mbrenda disa ditësh do të udhëtoja në terrenin shqiptarë me kompaninë "Bravo", edhe atë për një kohë të pa caktuar. Duhej të shkoja diku deri në afërsi të kufirit Shqipëri-Kosovë, diku shumë më afër vatrës së luftës, diku shumë më afër qendrës së zjarrit! Nuk e kisha ditën e caktuar se kurë do të nisemi, por më duhej të jam në gjendje gadishmërie për çdo kohë. Sot e kisha një ditë shumë të lumtur sepse ishte hera e parë që po sa mora letrën e parë prej familjes, nga koha që kurë se erdha në Shqipëri. Ishte gëzim i madhë dhe një ç'lodhje për mua, sepse kjo ishte e vetmja lidhje që kishim tani për tani, për shkak se lidhjet telefonike ishin gati se të pamundura.

Kjo letër që mora tani, më shtyri prapa shumë shumë vitesh kur isha në shkollën e mesme dhe gjatë studimeve. Sa me nostalgji po i kujtoja ditët kur shkëmbeu letra me axhën Emin, i cili kishte shkuar në punë të përkohëshme në Wienë të Austrisë. Pranim me pa durim çdo ditë postën mos po na sjellë ndonjë letër prej tij, sepse ajo ishte i vetmi mjet komunikimi që po ndëgjoheshim me të! Me lidhjet telefonike të brishta prej këndeje nga Shqipëria e provova edhe disa here dhe fillova të bindem se ato ishin të pa mundura. E sa për telefonat satelitorë ushtarak, nuk na lejohej që të përdoren si lidhje civile, për shkak të kostos që kishin po edhe se ato ishin të rezervuara vetëm për shërbimet ushtarake. Po afrohej edhe ditëlindja e Liridonës vajzës më të madhe. Ajo kishte ditëlindjen pas një jave. Ajo po i mbushë 7 vjetë. Shkova përsëri deri te sportelet e aeroportit, aty ku kishim një duqan ushtarak për të blerë një kartë postale. Deshta të paktën që nëpërmjet sajë t'i shprehi urimet më të përzemërta bukurshes së babil! Kartë postalen që e bleva menjëherë e shkrova dhe ia përcolla nëpërmjet postës ushtarake, me shpresë që t'i arrijë para ditëlindjes së sajë, sepse zakonisht letrat nga baza për të arritur në SHBA vononin më tepër se një javë.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Mbi 1.5 milion Kosovar ishin ç'vendosë nga shtëpitë e tyre, tani mbi 900,000 prej tyre ishin larguar jashta Kosovës dhe mëse 100,000 të rinjë të moshës ushtarake nuk dihej se ku ishin! U raportua edhe për 4,600 shqiptarëve të ekzekutuar nga forcat kriminale



23 Nëntor 1999, Sojevë /Kosovë, Shahadija në mesin e ushtarakëve amerikan me Presidentin e SHBA's Bill Clinton.

serbe si dhe u dëmtuan apo u shkatërruan më shumë se 500 fshatra të Kosovës.

Rreth orës 16:10 pas dite forcat aleate bombarduan urën mbi lumin Nishava në qendër të Nishit, prej nga informohet se u dëmtua edhe konsolata Greke si dhe parkingu i autobusave të Nish Express'it. Këto sulme të kryera mbi urë ishin në një afërsi edhe të Shtabit të Armatës Jugosllave. U sulmuan edhe Ministria e Mbrojtjes Veri në Beograd, Ministria e Mbrojtjes Jug në Beograd, ndërtesa e Stafit të Përgjithshëm të Armatës si dhe antenat e komunikimit satelitor në Beograd. U sulmua edhe Shtabi i Përgjithshëm i Policisë Speciale MUP të Republikës Federale të Jugosllavisë si dhe depoja e armëve. NATO sulmoi edhe transformatorin e rrymës elektrike në stacionin 3,5 dhe 8 në Beograd dhe Obrenovac.

E diel 9 maj 1999

Sot ishte një festë mjaftë madhështore në Amerikë, ishte dita e nënës. Në mëngjes përsëri shkova deri në aeroport me shumë shpresë se mos po kisha fatin që të lidhemi në lidhjet telefonike me Shahadijen. Deshta që ta provojë të paktën mos po kam fatin ta marr në telefon që të mundë t'ia urojë festën asajë, nënës së dy bukurosheve tona më të mira. Përsëri edhe kësajë here ishte e kotë! Dështova dhe prej aty vendosa që të ndalem për disa minuta edhe në vetëshërbimin ushtarak që e kishim aty afër pakë më tutje mbrenda Aeroportit të Rinasit. Më tepër po shkoja sa për të parë se ç'kishim në këtë shitore. Për fat t'imin edhe shitorja qëllloi e mbyllur sepse tani kishin kohën e pushimit. U ktheva në çadër sepse nuk deshta të pres aty më tepër, sepse shkruante se do të hapej pas një ore.

Telefoni dhe shitorja ishin në një largësi bukur të madhë nga çadra ku ishim të vendosur ne, por dikur më vonë vendosa që përsëri të kthehesha atje. Po mbante mjaftë kohë e nxehtë, u nisa ngadalë edhe atje mbërrita diku rreth orës 12:00

në mesditë. Pas të gjithë asajë rruge që bëra përsëri ishte e kotë, sepse shitorja ishte e mbyllur përsëri për shkak të mungesës elektrike! Atje qëndrova deri në orën 13:00 duke pritë se mos po rregullohet rryma që të hapet shitorja. Gjatë kësajë kohe sa prita aty takova një shqiptarë lokale që po punonte aty, por tani kishin dalë që të gjithë punëtorët jashtë për shkak të mungesës së rrymës elektrike. Filluam të bisedojmë duke pritur derisa të vijë rryma. Gjatë bisedës ajo më pyeti se pse unë nuk shkoj t'i bashkangitem në radhët e UÇK-së? Disi mbeta i shokuar prej asajë pyetje! Përgjigjeja ime ishte: "Lash jetën time që e kisha rregulluar bukur mirë, lashë familjen, pra gruan me fëmijët e mitur edhe erdha këtu mu për atë qëllim. Ndoshta po më sheh tani që jam në krahun e UÇK-së që t'i ndihmojmë ata, pasi se kjo ushtri është aleati më i madh i shqiptarëve që kemi patur ndonjëherë. Saktë për këtë edhe vendosa që t'i bashkangitem kësajë force, Armatës Amerikane!". Pastaj unë pa mëdyshje e pyeta zonjën shqiptare: "Ju a keni ndonjë pjesëtarë të familjes tuaj që iu ka bashkangitë apo po ndihmon UÇK-në?" Ajo me mimikat e saja më shikoi mua si të çmendur dhe për menjëherë mu përgjigj: "Jo! Pse në të luftojmë, ne nuk kemi kurrëfarë problemi prej këndeje. Ne jemi mirë, ai problem atje është i tyre, i kosovarëve. Ata duhet të luftojnë!" Mbeteja i shokuar nga fjalët e saja. Sa e kuptova unë, ajo ishte një vajzë e re, e bukur me flokë kaçurrela por tepër arrogante. Mua më dukej se ajo nuk kishte pasë gjak shqiptari! Fjalët që m'i tha kjo arrogante, më la përshtypjen se nga "Nëna Shqipëri", ndoshta nuk paskemi asnjë vullnetarë në aradhat e UÇK-së. Mua më dukej se ajo ishte një arrogante që urrente kosovarët tej mase! Nuk munda ta durojë më, edhe unë disi nga zemra e plasur i thashë diçka palidhje: "Po, ju s'keni kohë të ndihmoni vëllezërit tuaj, sepse ju jeni në luftë në mes veti. Edhe mu për këtë ne me ushtarët amerikan jemi të detyruar që edhe këtu mbrenda Shqipërisë të ecim të mobilizuar sikur me qenë në

gjendje lufte edhe këtu. Po, sikur me qenë në frontin e luftës për shkak të kriminalitetit që keni në këtë vend!" U largova nga ajo kinse po shikoja diçka tjetër mbrenda objektit të aeroportit. Kishte qenë shumë më mirë e që mos ta kisha taku këtë vashë, sepse me të vërtetë më demoralizoi tej mase.

U bë ora 13:00, tani sa erdhi rryma edhe shitorja u hapë për menjëherë. Hyra mbrenda për të blerë ndonë send, por nuk gjeta asgjë që më interesonin mua. Kot që e kisha bërë të gjithë atë rrugë për asgjë. U ktheva në çadër i dëshpëruar nga takimi me atë punëtorin shqiptarë që më mirë mos ta e kisha takuar, po edhe nga rruga e kotë që bëra nëpër atë zheg dhe pluhur të madh. Me të kthyer në çadër u zbatha dhe u shtriva në krevetatin e aluminit të mbuluar me një qebe dhe thesin tim të gjumit. Fillova leximin e një libri të shkruar nga Tom Brokaw, një gazetarë i njohur Amerikan të cilin e bleva në Aeroportin e Atlantës së Georgias në SHBA gjatë rrugës për në Shqipëri. Ky libër ishte një përmbledhje e intervistave të Tom Brokaw si gazetarë me disa pjesëtarë të luftës së dytë botërore, si ajo në Normandi dhe disa vendeve tjera të Evropës. Rreth orës 18:00 të mbrëmjes erdhi Kapiteni Lerner aty afër, ashtu i qetë si çdo herë edhe më pyeti: "A don të vishë në mbledhjen e Shtabit të Përgjithshëm, e cila po mbahej çdo ditë në orën 19:00 për komandën ushtarake. "Po" iu përgjigja, dhe së bashku me kapitenin shkuam në mbledhje, edhe kësajë here më tepër shkova për të ndëgjuar informatat më të reja nga zonat e luftës në Kosovë. Si çdo herë edhe sot mbledhja filloi me planet 3 ditore të armatës, dhe pastaj vazhdoi edhe për gjendjen e luftës mbrenda Kosovës. U informova për numrin e madh të refugjatëve që kishin hyrë në Shqipëri dhe Maqedoni mbrenda ditës së sotme, gjithashtu edhe për luftimet e rrepta të UÇK-së me forcat serbe që po zhvilloheshin në afërsi të Junikut. Pjesëtarët e UÇK-së me luftimet e tyre po mbanin të hapur koridorin për furnizim me armë në mbrendësi të Kosovës prej

Shqipërisë. Aty gjithashtu ndëgjova edhe lajmin më të hidhur për vrasjen e albanologut dhe aktivistit të madh të çështjes shqiptare Prof. Dr. Fehmi Aganit, për vrasjen e të cilit kishin dy informacione: njëra ishte se na qenka vrasë nga pjesëtarët e UÇK-së, (krejtë pa bazë!) dhe tjetra të së cilës më tepër i besonim të gjithë se ishte nxjerrë nga grupi i refugjatëve kosovarë nga forcat kriminale serbe edhe ishte pushkatuar së bashku me burrat e tjerë. Lajmi i vrasjes së prof. Dr. Fehmi Aganit më tronditi pa masë, sepse këtë profesor e kisha taku shumë vite më herët. Ishte një shkencëtarë i sociologjisë dhe atdhetarë i madh i shqiptarizmit. Ç'të bësh, kur vrasjet e shqiptarëve në Kosovë janë diçka e zakonshme, sepse atje njerëzit e pa fajshëm vriten çdo ditë. Jeta e tyre është si asgjë, dhunohen dhe masakrohen gjithëandej vetëm e vetëm pse janë shqiptarë!

Gjatë mbledhjes u bisedua edhe për bombardimet e NATO's që po vazhdonin edhe mbrenda në Serbi, si dhe për bombardimin e Ambasadës Kineze në Beograd që sapo kishte ndodhur dhe po dyshohej se aty mbrenda ambasade ishin radiolidhjet kryesore të Shtabit Policor-Usharak të Serbisë. Nga ana tjetër Kina dhe Rusia ishin ata që ende po përkrahnin Presidentin Jugosllav Millosheviqin! U bisedua edhe për bombardimin e Radio Televizionit të Serbisë, ku kishte të vrarë edhe disa gazetarë. Pas informatave për Kosovën, unë u ngrita ngadalë pa i pengu të tjerët edhe u largova nga mbledhja që tani do të fillonte në përgjithësi për planet e ardhëshme të luftës. Prej mbledhjes shkova përsëri në çadrën time dhe atje vazhdova me leximin e librit që e kisha filluar më herët dhe të cilin e lexova deri vonë në mbrëmje.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Pikat strategjike të sulmeve të NATO's gjatë ditës së djeshme ishin: Aeroporti i Nishit edhe ai i Prishtinës si dhe Galenika. U sulmuan edhe urat në Nish, Crepij edhe Magric, transmetuesi televiziv në Kradulevec, radio riley në Novi Pazar, Ivanica, Brudnic, Bladinovac, Losnika, shtabi i kazermës në Kragujevc dhe depoja e karburantit në Serbadjevo, Lokpaknica dhe Nish. Mbrëmë u sulmuan edhe 5 pozicionet e artilerisë dhe 6 pozicionet e mortajave në afërsi të Glearlanit, u sulmuan edhe 2 pozicione ushtarake, autoblanda, ushtarë, si dhe mjete tjera të trupave serbe, 1 radar si dhe shumë pozicione tjera mbrenda në Kosovë.

U bisedua edhe për marrëveshjen diplomatike në mes të envojit Rus Viktor Chirnomyrin, Kancelarit Schreder si dhe anvojit special të posazgjedhur Mr. Carl Bildt të OKB, bisedë e cila ishte mjaftë e suksesëshme pasi se Rusia po qëndron në principet e G8. Gjatë ditës së djeshme kishte pasë takime dhe në mes të Kancelarit Schreder dhe udhëheqësit kosovar Ibrahim Rugovës, i cili tani ishte në Romë, ku po kërkonte që refugjatëve kosovar t'i lejohet kthimi sa më i shpejtë në shtëpitë e tyre dhe në vazhdim të bëhej edhe marrëveshja politike e Kosovës.

Ehënë 10 maj 1999

Gjatë natës kishte shi me shumë frymë dhe me shpejtësi mjaftë të lartë, ndoshta ka arritë edhe me mbi 50 kmh, dhe gati sa na i mori edhe çadrat tona! Nga era e fortë edhe shiu filloi të na pikojë edhe për mbrenda çadrave!

Gjatë ditës edhe sot ishte ditë e qetë, nuk kishte kurrëfarë lëvizjesh me rëndësi. Më vonë filloi një ditë e mirë me diell, dhe kohë pas kohe me pak re. Tani sa më lajmëruan që të bëhem gati për nesër. Më lajmëruan para kohe edhe pse ne gjithëmonë ishim të gatshëm, sepse kishim vetëm se nga një thes ushtarak me veshëmbathjet mbrenda tijë, dhe nga një çantë me disa sende personale. Këto më tepër ishin sende higjienike të përzier me ndonjë libër dhe fletore për të shkruar gjërat më interesante të ditës. Ne çdo herë ishim të gatshëm për në çdo moment të ditës apo natës. Më lajmëruan se nesër në orën 18:00 të mbrëmjes do të nisemi për në rrugë me kompaninë Bravo në drejtim të kufirit me Kosovën. Do të shkonim në një afërsi rreth 20 km., e sa më kujtohet mua, kjo ishte edhe hera e parë që po i afrohem kaq afër kufirit Kosovë-Shqipëri. Më lehtë e kam të them më afër kufirit shqiptaro-shqiptarë, të cilin na kishin caktuar të huajt. Siç e dijmë nga ana historike ky kufi na erdhi pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, atëherë kur pjesa më e madhe e tokave shqiptare iu dha Serbisë, Mali të Zi dhe Greqisë, kur edhe pushtohet nga sllavo-grekët. E gjithë kjo marri e ndarjes së tokave Arbërore u bë më 29 Korrik 1913 në Mbledhjen e Ambasadorëve të gjashtë fuqive botërore të kohës: Britanisë së Madhe, Francës, Gjermanisë, Austro-Hungarisë, Ruisë dhe Italisë. E ndanë popullatën dhe

tokat shqiptare në mes veti. E ndanë në pesë shtete, aty ku kufizohen shqiptarët me shqiptarë. Ja mu ashtu siç po shifet edhe në ditët e sotme, ndarje e cila na solli vetëmse vuajtje, vrasje, përdhunime, djegje dhe luftëra deri në ditët e sotme!

Informacionet e 24 orëve të fundit

Operacionet e sotme ishin më të pakta, ishin realizuar vetëm se gjysma e tyre për shkak të kohës së keqe. Sot gjithashtu sulmuan pikat strategjike duke i shkakto dëme edhe më të mëdha Millosheviqit. Sulmi vazhdoi në aeroportin e Nishit, u shkatërrua riley i radios ushake në Mitrovicë, Kotava dhe Novi Pazar, poashtu u sulmua edhe depoja e karburantëve në afërsi të Prishtinës. Nga sulmet e aviacionit të NATO's u asgjësuan 2 tanka afër Riznikut, 10 autoblanda në afërsi të Kalavës si dhe mjete ushtarake të kamoflazhuara në afërsi të Deçanit dhe Prizrenit, po ashtu edhe posti komandues në Gjakovë dhe një numër i qendrave ushtarake. Gjatë ditës së sotme patëm një sulm në afërsi të Lipjanit në Kosovë, kurse më vonë rreth orës 15:00 pas dite u sulmua edhe fabrika "Sloboda" në Çaçak, në qendër të Serbisë. Sulmi kishte ndodhë kryesisht në zonën industriale në lindje të qytetit, rreth një kilometër nga qendra e qytetit. Sipas informatave të UNHCR rreth 650,000 refugjatë ishin lajmëruar deri më sot në Shqipëri dhe Maqedoni, dhe tani në partneritet NATO'ja dhe UNHCR me organizatat humanitare duhej ndihmuar këto refugjatë me veshëmbathje dhe ushqime...

E martë 11 maj 1999

Pasi mora lajmin se sot do të nisemi rreth orës 18:00 të mbrëmjes, përsëri erdhën kolegët



17 Qershor 1999 Sojevë /Kosovë, në këtë shtëpi kaluam natën e parë në Kosovën e Lirë me të njëjtën Njësi Speciale Amerikane nga Kukësi në Shqipëri.

ushtarak dhe më thanë të behem gati se do të nisemi edhe më herët se ishte planifikuar kjo rrugë të gjatë me njësinë Bravo. Unë veçse isha i gatshëm, dhe dikur rreth orës 13:30 i gjithë personeli ushtarak që po shkonim filluan përgaditjet e mëdha për në rrugë që do të ndërmarrim. Kështu që në orën 16:00 veçse u nisëm dhe dolëm nga baza ushtarake e Rinasit. Një orë para nisjes, me të shpejtë shkova edhe bëra një dush, sepse nuk i dihej se kur do të ktheheshim këtu në bazë. Po bisedohej se do të shkojmë në rrugë për tërë javën, e ndoshta edhe për më gjatë. Edhe kësajë here, sikur herave tjera, nuk kishte ujë të nxehtë. Ashtu si çdo herë më parë u pastrova me ujë të ftohët, edhe atë sa për të freskuar trupin pakë.

Pasi u nisëm, kapiteni Lerner më tha se kemi marre një rrugë bukur të gjatë, edhe atë do të shkojmë krejtësisht afër kufirit me Kosovën. Ky ishte një lajm që më gëzoi pak, dhe më tha se pika jonë strategjike ku do të qëndrojmë për një kohë do të jetë përtej qytetit të Shkodrës, diku në male në afërsi të qytetit të Pukës.

Rruga që morëm ishte e ngadalshme por edhe e vështirë, për të gjithë kolonën ushtarake që kishim rrugë të drejtimit tonë ishin të ngushta dhe mjaftë të rrënuara, e sidomos për automjetet e rënda ushtarake. Me vete kishim një kolonë mjaftë të gjatë ushtarake me: Lancuesit Raketurë MLRS, kishim edhe shume kamiona ushtarak, cisternën e karburantit, cisternë uji të pijshëm si dhe shumë Humvee's. Kaluam Fushë Krujë aty rreth orës 17:30 të mbrëmjes. Në qytet kishte mjaftë trafikë njerëzish dhe automjete të qytezës. Gjatë rrugës së qytetit derisa po kalonim më ranë në sy edhe disa të rinjë me uniformat ushtarake të UÇK-së, pamje që më gëzoi shumë. Gjatë rrugës gjithkund fëmijët po na pritnin me duartrokitje dhe të bërtiturat e tyre të zakonshme: UÇK, UÇK, UÇK, edhe na përshëndesnin me duartë lartë. Po edhe me dy gishta lartë në shenjë të V's (Fitore/Victory). Gjatë këtijë udhëtimit për kapiten tani kisha një personel tjetër ngaqë kisha në herët e më parëshme, quhej Buth. Edhe ky kishte respekt të madh ndaj meje, edhe ishte mjaftë shoqëruar. Tani po kalojmë dhe në afërsi të qytetit të Lezhës, një vend historik të një rëndësie të veçantë për ne shqiptarët. Qytetin ku u bë "Lidhja e Lezhës" e cila ishte e një rëndësie të veçantë historike. Po, sepse aty u bë një aleancë ushtarake e themeluar me 2 Mars 1444, në krye me prijësin tonë legjendar Gjergj Kastrioti-Skenderbeun. Ky ishte kryeprijësi prijësve Arbërorë dhe të tjerëve për rreth, që të bashkuar të luftojnë kundër Perandorisë Osmane. Anëtarët kryesorë të besëlidhjes ishin: Arianitët, Balshajt, Muzakajt, Spanët, Zahariajt dhe Gjurashët, e që Barleti e quajti "Generalis Concilium Universum Concilium" (Këshilli i përgjithshëm). Kuvendi i Lezhës apo "Besëlidhja e Lezhës" është edhe si pikënisja e krijimit të shtetit të parë shqiptarë. Në Lezhë gjithashtu kemi edhe varrin e kryetrimt tonë legjendar Gjergj Kastriotit-Skenderbeut, i cili u varros aty pas vdekjes së tijë më 17 Janar 1468 në kishën Shën Kollit.

Më vonë pas pushtimit të Krujës më 1480, pas 12 vjetësh pas vdekjes së heroit, thuhet se eshtrat e Skenderbeut u zhvarrosën nga ushtarët e Perandorisë Osmane, me qëllim që do ti përdornin eshtrat e kryetrimt si hajmali për t'u mbrojtë dhe për t'i dhënë kurajo për në betejat e mëtutjeshme me Arbërorët!

Qytetin e Lezhës e kaluam edhe nën eskortën e policisë shqiptare, e cila na udhëhoqi që nga nisja në Bazën Ushtarake të Rinasit. Kolona ushtarake ishte mjaftë e gjatë, ishte edhe më e gjata që kishim patur gjerë më tani, që edhe na vështirësonte për lëvizje më të shpejtë. Nëpër secilin vendbanim që po kalonim, rrugët ishin të stërmshura plotë me njerëz, ndoshta edhe nga shtimi prej popullatës me ardhjen e refugjatëve nga Kosova e pushtuar nga forcat slave. Por, ishte edhe kohë e mirë pranverore kur shumica e popullatës dalin për të bërë xhiro. Tanimë ishte errësuar. Nga ramja e territ të natës, me të dalë largë nga Lezha, u ndalëm afër një stacioni hekurudhor mjaftë të madhë por krejtësisht i boshadisur dhe shkatërruar. Ky stacion më tepër po i përngjante më shumë një gërmadhe sikurse pamjet nga filmat për luftën e dytë botërore, kur gjithçka ishte e shkatërruar nga bombardimet dhe e lënë pas dore! Jo veçse stacioni hekurudhor që kishte një pamje të tillë, por edhe më tepër kishin përjetu uzinat që pamë gjatë rrugës e që po i përngjanin më tepër sikurse me i pasë kapë shkatërrimi i bombës atomike të Hiroshimës apo ajo e Nagasakit. Ishin me një pamje shumë të tmerrshme dhe të mjerueshme, gjithkund po shihej shkatërrim i dhimbshëm. Në afërsi të këtijë stacioni hekurudhorë stopuam dhe aty do të kalonim këtë natë të qetë pranverore.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë ditës së sotme forcat e NATO's sulmuan pikat strategjike jugosllave si dhe mbi forcat serbe në Kosovë. Sot u sulmuan 7 radio riley në Savac, Cenika, Ivanicka, Ferizaj, Azar, Kosovska dhe Kruçivac. Këto rileyë po shfrytëzoheshin nga forcat serbe të intelgjencës. U sulmuan edhe 7 ura, si dhe ura e hekurudhës në Gradilishka.

NATO konfirmoi se sot aviacioni i tyre kishte bombarduar depon e karburantëve "Jugpetrol" si dhe aeroportin e Nishit. Gjithashtu sot pati sulme dhe në depon e gasit "Energogas". Gjatë ditës së sotme në orën 21:30 të mbrëmjes u sulmua edhe në jug të qytetit të Nishit. Sipas informatave të Tanjug'it, gjatë këtij sulmi u lëndua edhe Nënkrjetari i Partisë Socialiste si dhe Nënkrjetari i Këshillit Republikan për të cilët u tha se derisa ai me grupin e tijë po vizitonin "Jugpetrolin" ndodhi sulmi. Sot u bombardua edhe ura mbi lumin Moravë në Vladiçin Han në juglindje të Serbisë.

Sipas NATO's u tha se ata ende nuk kishin parë kurrëfarë ndryshimi në lidhje me tërheqjen e trupave serbe, siç ishin marrë vesh me to, "por edhe sikur të ishte parë ndonjë lëvizje e vogël "pjesërisht" ajo nuk është mjaftë për ne" kishte

thënë Sekretari i Mbrojtjes së SHBA'së William S. Cohen. Nesër në mëngjes pritet që të shkojë në Shqipëri edhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB'së, për t'i parë prej së afërmi refugjatët shqiptarë dhe pasdite të vizitohë refugjatët edhe në Maqedoni.

E mërkurë 12 maj 1999

Pasi u zgjuam, dikur rreth orës 9:00 të mëngjesit, përsëri vazhduam rrugën përpjetë për t'iu ngjitur maleve të Alpeve Shqiptare, male të cilat kishin një pamje të bukur dhe shumë mahnitëse. Vende vende nëpër disa majë malesh ende po shihej dëborë e bardhë që prej së largu duke sikurëse malit i kishin vu plisin e bardhë, edhe pse ishim gati në gjysmën e Majit! Rrugëtimi ndërmjet maleve të larta na mori disa orë udhëtim. Këto rrugë ishin mjaft të ngushta, me lakesa të mëdha gjarpërore dhe shumë të vështira për të kaluar automjetet e rënda ushtarake. Gjithashtu të vështira ishin edhe për automjetet me karburantë furnizues si dhe Lancuesit Raketorë MLRS. Shkuam deri në afërsi të Shkodrës, dhe pastaj morrëm rrugën në të djathtë të qytetit dhe vazhduam përpjetë ku më vonë arritëm në një majë mali. Kishim arritur diku në mes të Shkodrës dhe Pukës, por shumë më afër qytetit Pukës. Atje kishim edhe njëherë nga pikat tona strategjike në rast të ndonjë sulmi. U ndalëm në një lëndinë dhe morrëm pozicionet tona të nevojshme, ku gjithëçka që kishim për rreth e mbuluan me mbulesën tonë me rrjetin kamuflazhë ushtarak. Këtë e bëmë për mos t'u hetuar nga rrethi prej së jashtëmi, pasi se tani veçse ishim ndoshta edhe mbrenda perimetrave të artilerisë serbe. Edhe sot po përjetonim edhe një ditë shumë të bukur dhe me diell, me një erë mjaftë freskuese dhe me gjelbërim të maleve gjithëandej për rreth nesh. Këtë ditë e kaluam sikurëse edhe shumë herave të tjera: pusho, ha, pi dhe gjumë nën qiell të hapur. Në rrafshnalta tendat i stacionuam veçse disa kilometra largë qytetit të Pukës. Aty kishim një rreth malorë me shkurre por me gjelbërim, por edhe mjaftë piktoresk. Diku rreth orës 15:00 pas dite patëm edhe vizitën e parë në këtë bazë të ushtarakë, ishin dy helikopterët e Armatës Amerikane "Black Hawk", të njohur nga shumë beteja të më herëshme të ushtrisë amerikane: në Vietnam dhe Irak, të cilët erdhën dhe na sollën postën dhe ca pjesë të automjeteve të cilat ishin kërkuar nga komanda jonë. Ishin kërkuar sepse gjatë rrugës malore në mes të Shkodrës dhe kësaj pike, atje afër dikund na mbeti në rrugë njëri nga Lancuesit Raketorë MLRS nga një defekt teknik, të cilit iu prish transmissioni! Në këtë rrafshlartë tani do të kalojmë dhe natën e parë të rrugëtimit. Gjatë mbrëmjes, nata ishte e kthjellët dhe me shumë yje. Tani ishim krejtë largë nga qytetet dhe vendbanimet. Nuk shihet kurrëfarë drite, përveçse kohë pas kohe nganjëherë ndritej i tërë qielli në distancë dhe pas disa sekondash ndëgjohej edhe bubullima nga bombarduesit e NATO's mbi forcat paramilitare ushtarake serbe. Bubullima ishte ajo që e pëlqej pa

masë, sepse më tregonte se diçka po bëhej për të mirë në emër të "Lirisë" së më të dashurve tanë, të vëllezërve dhe motrave tona në Kosovën martire!

Informacionet e 24 orëve të fundit

Mbrëmë kishim 24 orëshin më të nxanun të kampanjës që nga fillimi i bombardimeve të NATO's. U tha se patëm 327 fluturime e që deri më tani ishin bërë rreth 20,000 fluturime dhe të cilat sulmuan forcat e Millosheviqit edhe në tokën e Kosovës. Caqet kryesore përsëri ishin tanket, autobлиндat, armët artilerike, armët kundërajrore, mortajat, postet komanduese, grupet ushtarake në veçanti në "Suva Rekë- Therandë", Junik dhe rreth Shtimjes si dhe u sulmuan edhe shumë kamione ushtarakë serb.

Pikat strategjike që u qëlluan gjithëandej Jugosllavisë ishin: 5 aeroporte, 8 ura dhe 4 vende me material luftarak. Me shumë sukses ishte sulmi i djeshëm mbi Forcat Ajrore Jugosllave, ku i shkatërruan 5 aeroplanë luftarak MiG 21, gjë që do t'i dobësojë pa masë Forcat Ajrore Jugosllave. Me këtë po i bëhej e ditur se Millosheviqi nuk ka kurrëfarë rrugëdalje pos pranimit të 5 pikave kryesore të NATO's, dhe tërheqjen e tërësishme të forcave serbe nga Kosova.

E enjte 13 maj 1999

Pasi se u zgjuam sot herët, disa nga mekanikët ushtarakë shkuan që të ndihmojnë në rregullimin e Lancuesit Raketor MLRS që kishte mbetur gjatë rrugës, e që më vonë do ta e sjellnin këtu ku ishim përqendruar për momentin. Në fytyrat e shumicës së ushtarëve shihej njëfarë zhgënjimi sepse shpeshëherë më thonin: "Ne kemi ardhë këtu për të kryer një detyrim që e kemi, dhe pastaj të kthehemi prej andej nga erdhëm, e jo për pushime në malet e Alpeve të Shqipërisë!"

Sot ishte një ditë e veçantë për mua, sepse sot është ditëlindja e vajzës time më të madhe, ditëlindja e bukuroshes së babet Liridonës! Këtë ditë të cilën kisha dëshirë që ta festonim së bashku me të gjithë anëtarët e familjes, por për tani kemi diçka edhe shumë më të rëndësishme të këtyre viteve, luftën për lirinë e popullit tonë shqiptarë.

Për fatin tim, as që do të kem fatin që të paktën t'ia kisha uruar nëpërmjet telefonit. Sot bukuroshja e babet Liridona po mbusë 7 vite. Urime bija e babet, të urojë gjitha të mirat ty dhe të gjithë familjes!

Gjatë bisedës para disa ditësh me Kapitenin John Roadcap, kur po bisedonim edhe në lidhje me fëmijët tanë që kishim lënë në Amerikë, edhe gjatë bisedës i tregova se në ditën e sotme ka ditëlindjen vajza ime më e madhja Liridona. Gjatë kohës që po bisedonim sot me kapitenin Roadcap ai nuk më tha asgjë, mirëpo e kishte mbajtur në mendje shumë mirë ditëlindjen e Liridonës, dhe pa përmendë asgjë më vonë pas disa minutash po më thotë: "Të lutem eja me mua sepse kam lidhje të ngushtë me



19 Qershor 1999 Gjiilan /Kosovë, të ftuar në darkë solemne nga një grup të rinjsh Gjilanas në celebrimin e çlirimit të Kosovës.

mekanikun civil të Lancuesve Raketor MLRS, i cili ka një telefon satelitor të kompanisë së tij private. Do t'ia marrë për ta dhënë ty që t'i telefonosh familjes, të paktën sa për t'ia uruar ditëlindjen bukuroshes tënde. Por me kusht që bisedën ta keshë sa më të shkurtë dhe mos t'i tregosh askujtë. Askujtë sepse mundë t'i nxjerrim telashe kolegut për përdorime private të telefonit të tij satelitorë! "Kapiteni shkoi te shoku i tij, dhe ia kishte marrë telefonin satelitor dhe ma solli mua. Më tregoi se si përdoret, edhe më tha: "Tani ik pas kaçubeve dhe telefono familjen!" Mora telefonin dhe u fsheha pas kaçubeve që mos të shohë askush prej grupit tonë edhe telefonova shtëpinë. Ishte ora 14:00, që me kohën e Clevelandit ishte ora 8:00 e mëngjesit. Nga ana tjetër telefonin e hapi Shahadija e cila sa më duket ishte ende përgjumshëm. Bisedova shkurtë me Shahadijen, sa për tu ndëgju se si ishin e gjithë familja dhe ç'kishte të re atje. Pastaj bisedova edhe me Liridonën të cilës i urova ditëlindjen me shëndet dhe me jetë të gjatë dhe të lumtur. Pas sajë bisedova edhe me Mimozen të cilat ishin zgjuar edhe u gëzuan pa masë që bisedum në telefon, sepse kjo ishte hera e parë që po bisedoja edhe me vajzat. Më në fund u përshëndetëm dhe u ndamë nga biseda tepër e shpejtë dhe e shkurtër por tepër e vlefshme. Ia ktheva telefonin kapitenit edhe iu faleminderova shumë me gjithë zemër për shërbimin që më bëri kapiteni Roadcap me shokun e tij. Gjatë ditës në këtë vend qëndrim erdhi një djalë kurioz lokal rreth 10-12 vjeç, për të na parë se ç'po bënim. Iu afrova dhe e përshendeta, përnjëherë fytyra e tij buzëqeshi pasi se më ndëgjoi që po i flisja shqip. E pyeta se prej nga na erdhe, pasi se aty për rreth nuk shihej kurrëfarë vendbanimi? Më tha se ishte nga fshati Dedaj, aty afër ku ishim vendosë ne, dhe jo aq largë edhe nga qyteti i Pukës. Për menjëherë më tha: "O ti qenke shqiptarë". Iu përgjigja: "Po edhe unë jam shqiptar si ti". U gëzua shumë pse i fola. Më tregoi se në familjen e tij kishin marrë edhe shumë refugjatë nga Kosova që kishin ardhë në fshatin Dedaj. Më pyeti se kur do të shkonim që t'i shporrim forcat serbe nga Kosova? Unë iu përgjigja se do të shkojmë së

shpejtë, veçse jemi duke pritur kur të na jipet urdhëri! Deri sa po bisedonim, me njëherë dorë nxorra disa sheqerka nga xhepi të cilat i kisha mbledhur nga ushqimet e paketuara ushtarake MRE që na vinin edhe lloje të ndryshme sheqerkash, për t'ia dhënë këtij bukuroshi të vogël i cili me sjelljet e tij ishte shumë i matur. Po sikurse me qenë i moshës shumë më të madhe! Mirëpo për çudi ky bukuroshi i vogël refuzoi që t'i marrë sheqerkat duke më thënë: "Jo faleminderit shumë, ato janë për juve, unë nukë i marrë sheqerkat e tua!" Pasi se iu luta t'i merrte, më në fund ai i pranoi duke mu faleminderua me përkulje. Por disi sikur të ishte i penduar dhe duke më siguruar se mos po mbetesha unë mangu pa to. Pas gjysmë ore bisede kërkoi lejen që të largohet në drejtim të kafshëve që po i ruante në kullosë. Aty ku ai kishte 3 lopë për të cilët po kujdesej pak më poshtë në lëndinën tjetër, në një kullosë të bukur rreth 50 metra largë neve. Pas ndarjes me vogëlushin shqiptar, përsëri vazhdova me lexime derisa edhe po shijonim edhe të gjitha këto bukuri natyrore të maleve të rrethit të Pukës. Lexova për derisa filloi të errësohet dhe pastaj përsëri filluam të shijojmë dhe bukurinë qiellore me yje të pa numërta që shifeshin në horizont nga kjo pikë e lartësisë kodrinore. Nganjëherë shihej ndonjë meteor që dhezej për një kohë të shkurtër, por ajo më e bukura ishte kur kohë pas kohe përsëri po shifeshin drita si lloj vetëtime, e mëpas shoqërohej edhe me krismën e bombave nga bombarduesit e NATO's. Po, atje larg diku përtej kufirit shqiptaroshqiptarë që po bombardonin mbi forcat e armikut serb.

Informacionet e 24 orëve të fundit

U raportua se lidërsipi i NATO's është i vendosur që me çdo kusht ta përfundojë për gjithmonë agresivitetin dhe pastrimin etnik që po bëjnë forcat e Millosheviqit. Sot Presidenti Chirac do të flasë në orën 16:00 nga Moskva për kërkesat e Aleancës me palën ruse, që të insistojnë te Millosheviqi që të pranojë 5 pikat esenciale dhe të pa negociueshme të komunitetit ndërkombëtarë. Kryeministri Blair dhe presidenti Clinton janë të

vendosur në këto pika, dhe nuk do të ketë kurrëfarë lëshimi.

Në orën 11:50 të mbrëmjes u sulmuan Forcat e Armatës Jugosllave në fshatin Korishë në afërsi të Prizrenit, ku thuhet nga informatat e NATO's se ishte sulmuar posti komandues dhe kampi ushtarak i forcave serbe. Gjatë këtij sulmi forcave serbe i shkatërruan edhe shumë mjete ushtarake si: një autobлиндë si dhe më tepër se 10 pjesë artilerike që ishin parë në këtë lokacion. NATO nuk mundë që të konfirmojë numrin e viktimave, kurse pala serbe jep një numër të madh të vrarë të refugjatëve që ishin aty të vrarë nga bombardimet e NATO - së, e që nga NATO-ja mendohet se refugjatët po shfrytëzoheshin nga forcat serbe si mure mburoje e gjallë për ta.

Sipas informacioneve të Amnesty International thuhet se Korisha ishte sulmuar më herët nga forcat ushtarake policore para se të bombardohet nga NATO-ja. Gjatë vizitës së Gjeneralit Clark të nesërmen, thuhet se forcat ushtarake policore serbe po shfrytëzonin popullatën civile shqiptare, si mburojë të gjallë nëpër shumë vendbanime të Kosovës. Më 16 Maj 1999, një refugjat kosovar dëshmoi se kishte qenë në Korishë me atë grup kur u sulmua prej NATO-së, ku dëshmoi se policia jugosllave i kishte përdorë rreth 600 Kosovarë të çvendosur si mur të gjallë para se të sulmonin aeroplanët e NATO-së...

E premte 14 maj 1999

Sot u zgjuam herët në orën 4:00 të mëngjesit që të nisemi menjëherë për të dalë dhe për të caktu pika tjera strategjike të sulmit. Pasi u bëmë gati, nuk e dije se pse, por përsëri edhe ky plan u shty për më vonë.

Koha sot ishte e bukur me diell mirëpo pakë e freskët, ndoshta edhe pse ishim pothuaj se në majë mali. Më vonë mu afrova Kapiteni Roadcap edhe më tha: "Pasi se nuk e keqpërdore telefonin satelitor, tani pas disa ditësh ia marrim përsëri edhe bisedo me bashkëshorten dhe fëmijët". Për çka e faleminderova nga zemra për kujdesin që po tregojnë për mua. Pastaj filloi të më tregojë se edhe ai kishte një vajzë në moshë adolshente në shtëpinë e tij në Vest

Virxhinia (West Virginia). Më tregoi një rast kur vajza e tij kishte filluar të kalojë me një djalë të moshës së sajë të cilin Kapiteni Roadcap (babai i vajzës) nuk e kishte pëlqyer aq shumë për vajzën e tij. Pastaj ai vazhdoi të më tregojë se i kishte ftuar njëherë që të vijnë për në skarë (me pjekë mish në gril) dhe në gjuajtje me armë tek shtëpia e tij. Djaloshi i ri kishte pranuar ofertën për të ardhë dhe me shumë dëshirë për në shtëpinë e të dashurës. Më vonë kapiteni me të dashurin e vajzës dalin me familjen e tyre përjashta me pjekë në skarë mish, e pastaj për t'u ushqyer me mish të pjekur dhe me pije, ku marrin nga një birrë në dorë. Pas një kohe të shkurtër Kapiteni Roadcap i thotë atij djaloshtit: merre këtë shënjestër edhe shko edhe veje atje largë nja 20 metra më tutje për të gjuajtur me revole në shënjestër. Për derisa ky i riu kishte qenë entuziast i armëve, e merr shënjestrën dhe shkon në vendin e caktuar për ta ngulë në tokë. Posa e ngulë në tokë, ende pa u larguar nga vendi i shënjestrës, kapiteni e gjuan dhe e qëllon shënjestrën. Këtë gjest ai e kishte bërë me qëllim që ta frikësojë të dashurin e vajzës së tij, që të frikësohet i riu dhe të ndahet nga vajza e tij. Ashtu i kishte ndodhë! Që nga ajo ditë, më kurrë nuk e kishte parë më atë djalim me vajzën e tij! Ma tregoi si shembull sepse edhe unë kisha vajzat, që nëse edhe unë më vonë nuk ia pëlqejë vajzave të mia të dashurit e tyre, kjo ishte mënyra më e lehtë për t'i shkaktuar atyre ndarjen!

Edhe kjo ditë na kaloi e qetë dhe pa kurrëfarë lëvizjesh, por edhe mbrëmja ishte e qetë përveçse kohë pas kohe që përsëri po ndëgjohej ndonjë krismë e bombardimeve të avionit të NATO-së, si dhe ndonjë gjuajtje artilerike diku largë përtej kufirit të Shqipërisë në mbrendësi të Kosovës.

Informacionet e 24 orëve të fundit

Gjatë 24 orëve të fundit Forcat Ajrore të NATO's kishin numrin më të madhin e fluturimeve deri më sot. Patën 679 fluturime nga gjithësej 20,772 që ishin kryer deri më tani. Nga këto fluturime, 237 ishin kryesisht sulme kundër sistemit ajrorë dhe mbrojtjes ajrore serbe. Gjatë kësaj kohe u sulmuan pikat strategjike: komanda ushtarake jugosllave, u sulmuan 5 termocentrale prodhues elektrik, 3 aeroporte, 3 riletë të radios ushtarake, 2 ura, një depo karburanti si dhe një depo e municionit.

Aviacioni i NATO-së rreth orës 13:30 sulmoi mbi trupat ushtarake policore jugosllave në mes të Gjakovës dhe Deçanit, rreth fshatrave: Bistrazin, Gradishe, Madanaj, dhe Meje, por për sulmin piloti bombardues tha se kishte sulmu direkt mbi konvojin ushtarak serb. Nga informatat e NATO's u ndëgjuan, se pas sulmit të NATO-së forcat serbe kishin sulmuar popullatën e pa mbrojtur shqiptare në shenjë hakmarrjeje dhe kishin vrarë mëse 73 civil shqiptarë dhe kishin plagosur edhe shumë të tjerë. Ata tani po fajësonin sulmuesit e NATO-së. Për këtë incident edhe Gjenerali Clark

tha se duhet të bëhen hetime më të hollësishme në lidhje me këtë krim...

E shtunë 15 maj 1999

Përsëri u zgjuam në orën 4:00 të mëngjesit, pas ngrënies së mëngjesit në orën 5:00 filluam të lëshohemi kodrës te poshtë, rrugës në drejtim të qytetit të Pukës me një konvoj prej 12 automjetesh ushtarake: me kamiona ushtarak, Hamvee's dhe Lancuesit Raketorë MLRS. Pamja nga maja e malit ku ishim ne kishte një pamje të bukur spektakulare, me male edhe më të larta sipër nesh si dhe luginës poshtë neve. Rruga ishte e ngushtë dhe me shumë kthesa dhe shumë pluhur. Kaluam përmes qytetit të Pukës dhe pastaj filluam rrugën në drejtim të Kukësit. Pasi i kaluam disa dhjetëra kilometra, diku në mes të Pukës dhe Kukësit në anën e djathtë të rrugës, në një luginë lartë mbi rrugën tonë gjarpërore, pamë një kazermë ushtarake ku ushtarët e rojes ishin me uniforma ushtarake të UÇK-së Ishin dy të rinjë që po bënë roje në hyrje të kazermës të cilët prej së largu na përshëndetën me duart lartë, e që në hyrje kishin vendet e rojes si dhe afër tyre kishin dy shtyllat e larta. Në njërin kishin të varur flamurin e kuq me shqiponjën dy krenare, pra flamurin kombëtarë apo të Shqipërisë dhe në shtyllën tjetër kishin të varur flamurin e kuq me stemën e UÇK-së. Kur e pashë se ishte kampi UÇK-së, zemra mu bë mal nga gëzimi, sepse aty pashë prej së largu se si një grup të rinjesh tanë, tani po ushtronin dhe po skaliteshin për ta luftuar armikun fashist sllav. Rrugës më tutje gjithashtu hasëm në shumë traktora me rimorkio prapa tyre, apo karrocet e ngarkuara me pleq, gra dhe fëmijë. Po të ngarkuar me këto të cilët po ma lëndonin zemrën, ku shpeshherë duke i përshëndetur me lëvizjet e dorës më pikonin edhe lotët kur i shihja me fytyrat e tyre të lodhura nga vuajtjet dhe maltretimet që kishin përjetuar si dhe nga rruga e gjatë dhe e vështurë e tyre. Ndoshta ishin edhe pa ngrënë dhe pa pirë deri këtu në tokat e bekuara shqiptare. Kishin pamjet trishtuese të cilat të lëndonin shpirtin, disa na përshëndetnin e disa veçse na

shiqonin me sytë e tyre të habitur. Ndoshta edhe ishin të zhytur diku thellë në dhimbjet e pa numërta të tyre që kishin përjetuar. Pas disa kilometrash rrugë u ndalëm në një rrafshinë, e që sipas fjalëve të disave aty afër që takuam, na thanë se dikur në kohën e diktaturës (sipas fjalëve të njerëzve lokal) aty ishte punuar nga vëllezërit kinez, ku kishin dashtë për ta bërë Aeroportin e Kukësit në këtë vend! Gjatë bisedës me fshatarët, kuptuam se aty më herët kishte qenë i vendosur një kamp ushtarakë i UÇK-së deri para një muaji, e më vonë qenka gjuajtur me artileri prej forcave serbe, ku për fat të mirë predha e artilerisë serbe nuk e kishte arritë cakun që të qëllojë mbi kampin e UÇK-së. Ajo asgjë nuk kishte arritur, përveçse një të riu shqiptar të atij fshatit që kishte plagosur. Menjëherë pas atij incidenti forcat e UÇK-së ishin tërhequr më tutje edhe për disa kilometra. Po kishin shkuar atje më lartë në luginën përtej fabrikës së kromit, e cila ishte pakë më tutje prej neve ku po qëndronim. Më vonë vazhduam rrugën në drejtim të Kukësit dhe arritëm te një fshat në hyrje të Kukësit. Menjëherë pas qafës së malit ishte e vendosur ushtria e Shqipërisë, kurse pakë më lartë në kodër shiheshin ku ishin të vendosur edhe topat e artilerisë me kalibër të lartë të Shqipërisë, të vendosura në drejtim të Kosovës. Sigurisht se ishin të drejtuara për t'iu kundërpërgjigjë forcave serbe nëse sulmohen forcat e armatosura të Shqipërisë. Nuk ishin aq largë prej vendit ku po ndodheshim ne. Në njërin nga fshatrat që u ndalëm në afërsi të Kukësit ishte edhe fshati Myç Mamëz, për derisa ne po shiqonim për rreth u ndëgjuam një eksplozim i fortë i artilerisë serbe e që më vonë u pa edhe tymi dhe pluhuri lartë në kodrën e malit të Gjallicës. Krisma ishte aq e fortë sa që kapiteni që ishte me mua përnjëherë u shtri për tokë, mendoi se po na gjuanin neve! Unë u qesha me të, jo që isha ndonjë trim por ndoshta edhe nga mosdija ushtarake që kisha! Pakë më tutje, aty buzë fshatit takuam shumë fëmijë që loznin futboll me një lëndinë të hapur, dhe posa na panë neve fëmijët me vrap erdhën dhe filluan të na pyesnin se kush

ishim dhe ku po shkonim? Prej tyre kuptuam se shumica prej tyre ishin fëmijë të ardhur refugjatë në këtë fshat nga Kosova. Gjatë bisedës më treguan se aty afër ishte shtëpia e njërit që po jetonte në SHBA, dhe gjatë bisedës pasi se ma thanë emrin e tij e kuptova se ajo ishte shtëpia e një shokut tim nga Cleveland'i, ishte shtëpia e Kujtim Dautit. Me të njëfeshim dhe kishim bashkëpunuar për më tepër se 20 vjet në Cleveland të Ohio's, edhe i cili po planifikonte që më vonë edhe ai të vinte për Kosovën e lirë në detyrën e përkthyesit me Forcat e Armatës Amerikane. Gjatë mbrëmjes u kthyem diku në vendin afër rrugës Pukë-Kukës, ish aeroporti kinez apo si me thënë ku kishte qenë kampi i UÇK-së para disa muajsh. Aty u vendosëm që të kalonim natën. Meqenëse një pjesë e kolonës ushtarake u ndal diku afër Pukës, ne që vazhduam rrugën ishim me 3 Hamvee's. Meqenëse nuk ishim shumë veta në grup, vendosëm që secili prej nesh duhej të bënte roje derisa të tjerët të flejnë në thasët e gjumit që kishim. Tani për herë të parë më caktuan edhe mua për të bërë roje 3 orëshe, derisa të flinin grupi i ushtarëve të tjerë dhe më vonë për të më zvendësuar ushtari tjetër. Por mua meqenëse isha pa përvojë më lejuan që të zgjedhi ndërrimin e natës për të bërë roje e që unë zgjodha prej orës 21:00 sepse edhe ashtu e mendoja ende është herët edhe nuk do të më zë gjumi në roje! Unë zgjodha ndërrimin e parë prej orës 21:00 deri në 24:00 në mesnatë, e që ishte ndërrimi më i lehtë, pasi se edhe ashtu unë nuk kisha gjumë për momentin! Gjatë rojes ishte errësirë, kapiteni m'i dha një palë dylbija nate (night vision binoculares) të cilat për herë të parë po i përdorja, dhe më tha se për çfarëdo lëvizjesh na trazon edhe neve. Që të gjithë hynë në thasët e gjumit edhe ia futën gjumit si me pasë qenë në orë të kurrdisur. Deri sa bëja rojen e pashë se i tërë grupi që ishim, menjëherë ia futën gjumit edhe aty nga ora 23-24:00 filloi të bëhet si monotone roja, pasi se nuk ndëgjohej asgjë përveçse ndonjë gërrhatje e ushtarëve që ishin tretur në gjumë këtu afër meje. Në orën 24:00 u zgjua ushtari tjetër që

ishite afër meje i cili ishte caktua që të mbajë rojen e radhës për të më zvendësuar mua, kurse tani unë hoqa çizmet edhe hyra në thesin e gjumit tim i shtruar në lëndinë, dhe fjeta si qingji në natyrë të hapur me ajër të pastër dhe pa kurrëfarë mbulesë!

Informacionet e 24 orëve të fundit

Zëvendës Sekretari i Mbrojtjes së SHBA's Keneth Bacon, gjatë fjalimit të tijë tha se pa marrë parasysh aksidentin në Korishë, kampanja e NATO-së do të vazhdojë edhe më tej edhe me rritjen e sulmeve mbi forcat ushtarake policore jugosllave mbrenda Kosovës. Zëvendës Sekretari tha se gjërat do të rishikohen por nuk pritet që të ketë ndonjë ndryshim të madh në sulmet e ardhëshme.

Siç u vërtetua edhe dje nga Amnesty International se rajoni rreth Korishës është një rreth shumë aktiv i forcave serbe, si dhe gjatë asaj kohe kishte pasë shumë të shtyra armësh prej forcave serbe.

Sulmi i avionit të NATO-së ishte legjitim, dhe ishte një cak i qartë mbi forcat e armikut, por siç po shifet forcat serbe pas sulmit të NATO-së duket se kanë sulmuar refugjatët shqiptarë në shenjë hakmarrjeje kundër NATO-së. Këtë e kanë bërë me qëllim që vrasja e refugjatëve t'i mveshet bombardimeve të avionit të NATO-së...

E diel 16 maj 1999

Që të gjithë u zgjuam në ora 5:00 të mëngjesit, lamë sytë me ujë nga shishet që bartnim me vete, dhe vazhduam udhëtimin nëpër pikat tjera strategjike. Kohë pas kohe po bënë edhe kalibrimet tjera të Lancuesve Raketorë MLRS, siç kishim bërë gjatë të gjitha atyre ditëve që nga ardhja ime në tokën e bekuar shqiptare! Gjatë rrugës, nga radio-lidhjet kuptuam se sulmi ynë nuk do të fillonte më së paku gjerë më 17 maj, e kjo po bëhej për shkak se tani ishte në plan edhe vizita e zonjës së parë të SHBA's: Zonja Hillary Clinton në kampin e refugjatëve kosovarë në Maqedoni.

Me marrjen e këtij lajmi që të gjithë neve mbetëm të dëshpëruar, e sidomos unë që po e prisja me pa durim nga të gjithë këto shtyerjesh pa lidhje nga dita në ditë e sulmeve mbi forcat paramilitaro-ushtarake serbe. Ashtu të dëshpëruar por filluam që të ktheheshim dhe tani po ngjiteshim përpjetë në drejtim të Pukës, në rrafshlartën në malet drejtë bazës së re, atje ku ishim vendosë tani disa ditë më parë. Pak para hyrjes në qytetin e Pukës na u bashkangjitë edhe pjesa tjetër e kolonës ushtarake që e kishim lënë aty një ditë më herët, atëherë kur ne me 3 Hamvees vazhduam rrugën në drejtim të Kukësit. Derisa po ktheheshim ne në kalim e sipër, diku në të dalë nga qyteti i Pukës, lartë në qiell vërejtëm dy helikopterë ushtarak Amerikan Black Hawk që po na përcjellnin! Pas një kohe të shkurtër na u dha urdhëri që të ndalemi e gjithë kolona ushtarake. *Vijon*



05 Gusht 1999, në gjykatën e parë të Kosovës së Lirë me Kapitenin Jurist Charles J. Kovats, Jr. në Kampin ushtarak Amerikan "Bondsteel" / Kosovë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova barazon edhe me Andorrën



“Epoka e re”

PRISHTINË, 28 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në nuk ka arritur të arketojë më shumë se një pikë në ndeshjen e dytë në kuadër të kualifikimeve për “Euro 2024”. Pas barazimit si mysafirë në Tel Aviv kundër Izraelit, “Dardanët” kanë barazuar edhe në shtëpi në duel me Andorrën, me rezultat 1-1. “Janë disa arsye që lidhen njëra pas tjetër, pikë e parë nuk arritëm të thyejmë këtë bllokadë që bëri Andorra. Nuk arritëm të konkretizojmë rastet. Disa vendime të gjyqtarit që nuk mu duken në rregull. Është shumë herët që gjithçka ka përfunduar me këtë lojë, do të japim gjithçka që duhet, është shumë herët që të thuhet se gjithçka ka përfunduar. Siç e thashë po e përsëris është shumë herët që të dorëzohemi, i kemi këto lojë, nuk do të dorëzohemi, duhet të

mendojmë se si të kualifikohemi he jo në anët negative”, ka thënë përzgjedhësi Alain Giresse, pas ndeshjes. Përkundër mbizotërimit të plotë gjatë tërë ndeshjes, Kosova nuk arriti t’i gëzohet fitores së shumëpritur. Pjesa e parë u mbyll pa gola, edhe pse “Dardanët” patën disa mundësi. Në pjesën e dytë “Dardanët” filluan furishëm në kërkim të golit dhe në minutën e 59-të Edon Zhegrova shënoi pas asistimit të Milot Rashicës. Mirëpo, gëzimi i futbollistëve dhe tifozëve dardanë nuk zgjati shumë, ngase qysh në aksionin e parë pas pësimit të golit, Andorra arriti të barazojë rezultatin. Ishte Berto Rosas, i cili shënoi me gjuajtje me kokë pas harkimit të Alverdas. Në minutat në vazhdim Kosova u përpoq maksimalisht për të gjetur golin e fitores, por mbrojtja e Andorrës ishte e ngjeshur dhe nuk lejoi shumë hapësira për futbollistët dardanë.

Ndeshjet e radhës Kosova i zhvillon në qershor kundër Rumanisë në “Fadil Vokrri” dhe më pas si mysafirë kundër Bjellorusisë.

Zvicra regjistron fitoren e dytë, Skocia befason Spanjën

Në grupin ku është Kosova, Zvicra merr suksesin e dytë radhazi. Ekipi i drejtuar nga Murat Yakin korri një sukses të pastër 3-0 ndaj Izraelit. Golat u realizuan nga Vargas në fundin e pjesës së parë, ndërsa të dytën shënuan edhe Amdouni dhe Eïdmer. Zvicranët renditen në vendin e parë me 6 pikë dhe mbeten favoriti kryesor për ta mbyllur grupin si kryesues. Në Grupin A, Skocia ka surprizuar Spanjën, duke e mundur 2-0. 2 golat e McTominay befaskan skuadrën e De La Fuentes, duke e lënë kështu të dalë nga kjo ndeshje pa asnjë pikë.

SHKURT

Galatasaray, gati 7 milionë euro për Rashicën

Milot Rashica është prioriteti kryesor i Galatasarayt në afatin kalimtar të verës. Ylli “dardan” po shfaq formë solide në klubin turk, ku është i huazuar për një vit nga Norwich City. E mediumi turk “Hurriyet” raporton se klubi nga Stambolli i ka bërë gati 7 milionë euro të cilat do t’ia ofrojë klubit turk për kartonin e përfaqësuesit kosovar. 26-vjeçari ndihet mjaft i kënaqur në klubin nga Superliga turke ku dëshiron të vazhdojë të luajë edhe në të ardhmen. Sidoqoftë, i mbetet Norwichit të vendosë nëse do ta shesë apo jo ish-futbollistin e Werder Bremenit.

Rritet vlera e Zhegrovës

Futbollisti Edon Zhegrova po vazhdon paraqitjet e mira në Ligën 1 dhe me Kosovën. Repreruesi i Përfaqësueses së Kosovës këtë edicion me Lillen brenda 19 ndeshjeve ka shënuar dy gola e ka dhuruar pesë asistime në të gjitha garat. Prandaj, faqja e cila merret me statistikat e futbollistëve “Transfermarkt” e ka ngritur vlerën e 23-vjeçarit për dy milionë euro. Tani Edon Zhegrova vlerësohet shtatë milionë euro në tregun e transferimeve.

Po vazhdon me sukses demonstrimi dhe promovimi i sportit të xhudos

Në shkollën model “Qamil Batalli” në Prishtinë të martën u zhvillua demonstrimi dhe promovimi i sportit të xhudos në kuadër të programit “Kosova Shtet i Xhudos”. Nënprogrami “Xhudo në shkollë” është një nga komponentët kryesor të programit shtetëror “Kosova Shtet i Xhudos”. Ky komponent do të shtrihet në të gjitha shkollat dhe komunat e Kosovës. Me anë të këtij projekti do të zhvillojmë masovizimin dhe vazhdimin e sukseseve të sportit numër një në Kosovë. “Edhe sot ishte interesimi mjaft i madh i fëmijëve në këtë shkollë. Demonstruan trajneri Kastriot Cena dhe xhudistët e Klubit të Xhudos ‘Polic’ nga Prishtina”, thuhet në njoftimin e Federatës së Xhudos së Kosovës.

Lewandowski: Shqipëria ishte e organizuar mirë në mbrojtje

Roberto Lewandowski nuk arriti të linte gjurmë në përballjen ndaj Shqipërisë të cilën Polonia e fitoi me rezultat 1-0. Kapiteni i polakëve vlerëson lojën e Shqipërisë, ndërsa pranon se ky do të jetë një grup i vështirë. “Shqipëria ishte e organizuar mirë në mbrojtje, na la pak hapësirë. Sigurisht kishim kontrollin e lojës. Kemi shumë punë përpara dhe besoj se trajneri e di shumë mirë këtë. Kjo sfidë tregoi edhe një herë se ky është një grup i vështirë. Këto sfida që në letër duhet t’i fitosh do të jenë përcaktuese për këtë grup”, ka thënë Lewandowski.

Kosova publikon listën për ndeshjet kundër Polonisë

PRISHTINË, 28 MARS - Selektori i Përfaqësueses së Kosovës në Hendboll, Agron Shabani, ka shpallur të martën listën e hendbollistëve të ftuara për ndeshjet me Poloninë. Kosova e Polonia takohen në fazën e dytë të kualifikimeve evropiane për Kampionatin Botëror të këtij viti. Kombëtarja më e mirë pas dy ndeshjeve siguron biletën për në Botëror. Ndeshja e parë luhet me Bielsko-Biala të Polonisë, më 6 prill nga ora 17:45. Ndeshja e dytë është më 12 prill nga ora 20:15 në Prishtinë. Polonia ka përvojë të gjatë e të suksesshme në ngjarjet e mëdha të hendbollit. Rrjedhimisht është favorite. Por vashat “dardane” do të japin më të mirën për paraqitje të dinjitetshme dhe në kërkim të befasisë së madhe. Arritja në fazën e dytë kualifikuese është sukses i madh



për Kosovën.

Lista e hendbollistëve: Njomza Kelmendi, Elisa Mulaj, Melisa Mulaj, Shkurta Mehmeti, Mirrela Gjirkokaj, Yllka Shatri, Fitore Aliu, Arlinda

Hajdari, Natalija Milatovic, Pashke Marku, Albina Rugova, Venera Kafexholli, Rina Rexhepi, Leonora Demaj, Marigona Hajdari, Blerta Ahmetxhekaj, Suzana Ujkiq.

Shqipëria nderon 7 kampionë të sportit me titullin 'Ylli i mirënjohjes publike'

TIRANË, 28 MARS - Qeveria shqiptare, përmes një ceremonie të zhvilluar të martën paradite, ka nderuar me titullin "Ylli i mirënjohjes publike" 7 kampionë të sportit shqiptar. Bëhet fjalë për sportistë që janë shpallur

kampionë bote, Evrope etj., yje të sportit shqiptar që kanë ngritur flamurin kuqezi në arenën ndërkombëtare dhe që janë ende aktivë. Ata janë peshëngritësit Briken Calja dhe Erkand Qerimaj, mundësi Zelimkhan Abakarov, skiatorja Lara

Colturi, bilardisti Eklent Kaçi, boksieri Alban Beqiri dhe Gentiana Beqa në sportin e bodybuilding. "Ata na kanë bërë krenarë me forcën e shembullit të tyre, duke e përfaqësuar Shqipërinë me dinjitet të lartë", ka thënë kryeministri

Edi Rama. Këtë mirënjohje e ka mbajtur vetëm atletja Luiza Gega, pas triumfit vjet si kampione e Evropës, por tashmë ajo do ta ndajë këtë vlerësim edhe me mjaft kolegë të saj. Në këtë ceremoni morën pjesë të gjithë sportistët si dhe



drejtuesit e Ministrisë së Sportit e ata të KOKSh-it.

Sylvinho: Humbja e hidhur, por ne luajtëm me shpirt e zemër

TIRANË, 28 MARS - Përfaqësuesja e Shqipërisë e nisi me humbje ciklin kualifikues për Kampionatin Evropian "Euro 2024" që do të mbahet vitin e ardhshëm në Gjermani. "Kuqezinjtë" pësuan humbje në udhëtim kundër Polonisë (1-0). Përzgjedhësi i Shqipërisë, Sylvinho, i cili debutoi me "kuqezinjtë", e vlerësoi këtë humbje si të hidhur. "Një humbje shumë e vështirë. Ishte një ndeshje shumë e vështirë, pasi Polonia ka luajtur edhe në Botëror. Megjithatë skuadra ka bërë gjithçka mirë, duke kuptuar gjithçka që duhej të bënte dhe shkuam deri në fund, duke luajtur shanset tona për të shënuar. Luajtëm me shpirt e me zemër. Fola me djemtë në pushim të ndeshjes dhe u kërkova që mbrohemi mirë e të luajmë fort. Donim pikë dhe, pse jo, të fitonim. Nuk e humbëm kontrollin dhe mendoj se në aspektin taktik e organizativ ishim siç duhet në fushë. Barazimi do të ishte më i drejtë, por kështu është futbolli", ka thënë Sylvinho. Tekniku brazilian ka thënë se ende ka vend për përmirësim. "Zemra



dhe shpirti që unë kërkoj është ky. Në sensin organizativ reaguam shumë mirë, por kemi shumë vend për t'u përmirësuar, pasi duam të luajmë me topin dhe ta kontrollojmë lojën. Kemi për të korriguar diçka edhe në mbrojtje, por do t'i analizojmë të gjithë momentet e ndeshjes, për të parë se ku mund të përmirësohemi. Polonia është një skuadër që luan shumë me topa të gjatë dhe bëhet pak më e vështirë për t'u bërë presing atyre. Duhet ta korrigojmë këtë aspekt. Luajtëm me Gjasulën para mbrojtjes, vetëm për t'i fituar duelet ajrore. Kishim përballë një

skuadër shumë të fortë, por duhet të punojmë ende shumë që të rritemi sa më shumë në presing", ka shtuar 48-vjeçari. Në fund, përzgjedhësi i Shqipërisë u pyet nëse duhej të rrezikonte më shpejt për ta barazuar rezultatin. "Nëse do të rrezikonim më shpejt, mund të ishim ndëshkuar me golin e dytë dhe mbyllet ndeshja. Këtu lojtarët u treguan të zgjuar, duke ruajtur ekuilibrat. Zëvendësimet ishin pak për të përfutur në 10-15 minutat e fundit. Ndoshta mund të kishim rrezikuar më shumë, por do të ishte risk edhe për të pësuar gol", ka deklaruar Sylvinho.

Milwaukee e Denveri mbrojnë kreun në konferencat përkatëse

Detroit, 28 mars - Milwaukee mbron kreun e renditjes në Lindje pas fitores me rezultat 126-117 në fushën e Detroitit. Edhe pse pa Giannis, skuadra e Bucksit bëri një ndeshje të mirë, ku u dallua Middletoni, autor i 34 pikëve. Rikthehet te fitorja skuadra e Dallasit, që mundi me shifrat 127-104 Indianan, ndeshje ku dallimin e bëri Luka Donçiqi, autor i 25 pikëve. Fiton edhe Phoenixi, që



falë 24 pikëve të Bookerit, mundi me rezultat 117-103 Utah Jazzin, ndërsa Clippersat mposhtën me rezultat 124-112 Chicagon, ndeshje ku u dalluan Batum me 24 pikë, mbështetur nga Leonardo e Gordoni me nga 22 pikë secili. Minnesota, falë një loje të mirë kolektive (7 lojtarë mbi 10 pikë), mundi me rezultat 119-115 Sacramenton. Në krye të renditjes

në Perëndim ndodhet ekipi i Denverit, që fitoi ndaj Philadelphias (116-111), dy ekipe pretendente në konferencat përkatëse. Nikola Jokiqi, protagonist me një "triple double" (25 pikë, 17 rebounde, 12 asistime). Ingram, lider për New Orleansin, duke realizuar 29 pikë në fitoren me rezultat 124-90 ndaj Portlandit.

REZULTAT

Detroit - Milwaukee	117-126
Indiana - Dallas	104-127
New York - Houston	137-115
Utah Jazz - Phoenix	103-117
Denver - Philadelphia	116-111
Portland - New Orleans	90-124
Sacramento - Minnesota	115-119
Clippers - Chicago	124-112

Franklin: Do t'i jap fund njëherë e përgjithnjë karrierës së Joshuas

Më 1 prill në stadiumin "O2 Arena" të Londrës do të zhvillohet dueli i peshës së rëndë në boks mes britanikut Anthony Joshua (24 fitore, 3 humbje) e amerikanit Jermaine Franklin (21 fitore, 1

humbje). Për britanikun, ish-kampion bote në këtë Divizion, kjo është një përballje vendimtare për të ardhmen, pasi vjen pas dy humbjeve ndaj Usyk. Për këtë arsye, Franklin shprehet se do t'i

japë fund njëherë e mirë karrierës së Joshuas: "Të gjithë thonë se karriera e Joshuas është në fije të perit dhe se kjo sfidë është gjithçka për të. Ai mund të kishte zgjedhur këdo si rival, por më zgjodhi mua.

Ndoshta ai po përpiqet t'i dëshmojë vetes se mund të më bëjë diçka që Dillian nuk mundi. Joshua bëri zgjedhjen e gabuar, pasi s'do të ketë fitore ndaj meje. Unë kam ardhur në Londër për ta

zgjuar atë dhe pjesën tjetër të botës. Do ta mposht dhe do t'i jap fund karrierës së tij. Ai i ndryshon shpesh trajnerët, por një gjë s'do të ndryshojë, fakti që do të humbasë sërish", u shpreh Franklin.

SHKURT

Cikalleshi: Kjo Shqipëri meriton më shumë

Shqipëria u mund minimalisht 1-0 nga Polonia në ndeshjen e parë kualifikuese të "Euro 2024". Pas ndeshjes, për medie foli lojtari i kuqezinjve, Sokol Cikalleshi. "Normalisht që të gjithë e keni parë një kombëtare ndryshe, me shpirt gare dhe një kombëtare të denjë për t'i përfaqësuar të gjithë shqiptarët. Na mposhtën me gjysmë goli. Rastet i patëm. Përballë kishim një skuadër me lojtarë të fortë dhe portierë të mirë. Kjo kombëtare ka hapur një faqe të re që besoj se do t'i bëjë krenarë shqiptarët. Këtë kombëtare e kërkojnë të gjithë. E ardhmja? Normalisht ishte një nga ndeshjet më të vështira. Polonia është në krye të grupit. U mposhtëm me rezultat minimal. Me ato raste mund të bënim pak më shumë. Nuk ka rëndësi kush do të dalë në fushë në të ardhmen. E rëndësishme të kemi këtë shpirt gare", ka thënë Cikalleshi.

Bellingham: Ëndrra më e madhe të bëhem kapiten i Anglisë

Jude Bellingham pranon se ëndrra e tij më e madhe do të ishte të zëvendësonte një ditë Harry Kanen si kapiten i Anglisë, por pranon se do të duhet kohë që ambicia e tij të bëhet realitet. Mesfushori 19-vjeçar i Borussia Dortmundit po shkëlqen me fanellën e përfaqësueses dhe pas Botërorit ku tregoi se edhe në këtë moshë mund të jetë një lider, bëri paraqitje bindëse dhe në dy ndeshjet e para kualifikuese të "Tre Luanëve", kundër Italisë dhe Ukrainës. Kur "Channel 4" i bëri pyetjen mesfushorit pas fitores 2-0 në "Wembley", Bellingham u përgjigj: "Të jesh kapiteni i vendit tënd do të ishte ëndrra më e madhe dhe nderi më i madh në futboll. Por ka një listë të gjatë që unë e respektoj shumë dhe do ta pres radhën time. Ndërkohë që jam duke mësuar prej tyre".

Mourinho dhe Mançini në listë listën e PSG-së

PSG-ja pritet të bëjë ndryshime në rolin e trajnerit ku Christophe Galtier është i shkarkuar, ndërsa mediet analizojnë se kush mund të jetë pasuesi i tij në krye të ekipit francez. "Il Messaggero" shkruan se mes kandidatëve potencialë është Jose Mourinho. Trajneri portugez shihet në Paris si profili ideal për ta marrë drejtimin e PSG-së. Gjithnjë sipas medieve italiane, kandidat për ta marrë drejtimin e PSG-së është edhe Roberto Mançini.

Simeone, afër ndarjes me Atletico

Trajneri Diego Simeone dhe Atletico Madridi mund të ndahen në fund të sezonit. Mes trajnerëve të vlerësuar dhe të pëlqyer nga "Colchoneros" është edhe Gian Piero Gasperini. Sipas raportimeve nga "Tuttosport", tekniku i Atalanta në Serinë A pëlqehet shumë për stilin e tij të lojës sulmuese dhe intensive, ashtu siç edhe tifozët e duan. Situata do të qartësohet më mirë në fund të sezoni, nëse largimi i Simeones bëhet zyrtar dhe nëse Gasperini do ta pranojë ofertën e klubit spanjoll.

CONTRACT NOTICE**SERVICES**

According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 28/03/2023

Procurement No	Research	001	2023	221
----------------	----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY**I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)**

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. MujëKrasniqin.n.Ulpiana U1/1		
Town: Prishtina	Postal code: 10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala	Telephone: 038-542-865	
Email: zefshala@hotmail.com	Fax: 038-542-869	
Internet address (if applicable):	www.matherteresasociety	

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT**II.1) DESCRIPTION**

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority: Individual Research in 20 Selected multi ethnic Municipalities	
II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance (Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)	
	X Services
II.1.5) Short description of the object of the contract Individual Research in 20 Selected multi ethnic Municipalities	
II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV) □ 93.000.000.-8 □	
II.1.7) Variants are accepted	No <input checked="" type="checkbox"/>
II.1.8) Division into lots	Yes <input checked="" type="checkbox"/>
Lot 1 10 Municipalities in Kosovo	Lot 2 10 Municipalities in Serbia
Individual Research in 20 Selected multi ethnic Municipalities	
II.1.11) Estimated contract value: Approximately 30,000.00	

II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT**II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION**

Duration in months 3 month (from the contract signature)
or
Starting 01/05/2023
Completion 31/07/2023

SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION**III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT**

III.1.1) Performance security required	<input checked="" type="checkbox"/> NO
III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded (if applicable)	
III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject	No <input checked="" type="checkbox"/>

III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

III.2.1) Eligibility Requirements: <ol style="list-style-type: none"> Certificate of Business Registration Fiscal Number Registration VAT-Certificate if applicable Documentary evidence required Copy of documentary
III.2.2) Professional Suitability: <ol style="list-style-type: none"> Business Registration Certificate List of proposed experts and administrative staff and their cv-s References of previous experience in similar projects Documentary evidence required: Copy of prove documents
III.2.3) Economic and financial capacity <ol style="list-style-type: none"> Tax Verification from Tax Administration of Kosovo and Serbia (for Winner Company only) Certificate from Justice that's Company and person representative is not on any justice process (for Winner Company only) Company profile Documentary evidence required: Copy of documentary
III.2.4) Technical and professional capacity <ol style="list-style-type: none"> Business Registration Certificate List of proposed experts and administrative staff and their cv-s

3 References of previous experience in similar projects

Documentary evidence required:

Copy of prove documents

III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession	No <input checked="" type="checkbox"/>
III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the service	Yes <input checked="" type="checkbox"/>

SECTION IV: PROCEDURE**IV.1) TYPE OF PROCEDURE**

IV.1.1) Type of Procedure	Open
----------------------------------	------

IV.2) AWARD CRITERIA

Lowestprice

IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

IV.3.1) Previous publications concerning the same contract	No <input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.2) Conditions for obtaining tender dossier Time limit for receipt of requests for tender dossier: date 07/04/2023	
Payable documents	No <input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.3) Time limit for receipt of tenders Date 20/04/2023 time 14:00 place Prishtina	
IV.3.4) Time limits is shortened for submission of tenders	no
IV.3.5) Is tender security needed:	No <input checked="" type="checkbox"/>
IV.3.6) Tender validity period: date: 20/04/2023 days 30 or months 1	
IV.3.7) Tender opening meeting: Date 20/04/2023 time 14:30 place Prishtina	

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION**V.1) COMPLAINTS**

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. No. 04/L-042 on Public Procurement - Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract notice.

V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in Albanian, Serbian or English.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Kroje Gjiodaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f. "Fan Noli" Dujak KK Gjakovë nga kl I-VIII.

- Shkëlqim Rexha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 sh.m. profesionale "Gjon Nikollë Kazazi" Gjakovë.

- Valbonë Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë Tregti.

- Bujar Pozhegu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Stojkovic Jovanka shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Ekrem Rexha" Lubizhdë.

- Faton Alija shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Dëshmorët e Kabashit" Korishë.

- Amir Berisha shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Denis Saramati shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Heronjtë e Lumes" Vërmicë.

- Naim Asllani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Lidhja e Prizrenit" Prizren.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonicharsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 28.03.2023 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme me qira.

Shpallje Publike

T-23-06

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e restorantit të punëtorëve (Depo) në njësisë biznesore Industria Kimike.

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë

Data e shpalljes: 28.03.2023

Sqarimi: deri me 07.04.2023

Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 07.04.2023
Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e Divizioni i shitjes dhe qirasë.

Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur)

Afati i fundit i dorëzimit: 12.04.2023 në 11:00

Vendi i dorëzimit: Divizioni i shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A.
Parku Industrial, Mitrovicë

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku inustrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
Kontakti: Burim HAJDINI		Telefoni: +383 (0) 28 538 050
Email: hajdini_b@hotmail.com		Faksi: +383 (0) 28 539 202
www.trepccorporation.com		



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

FTESË PËR OFERTË FURNIZIM

Konform udhëzuesit të brendshëm për prokurim Nr. 1/2009, për Autoritetet e Likuidimit

Data: 29.03.2023

I: AUTORITETI KONTRAKTUES: Agjencia Kosovare e Privatizimit, Autoriteti i Likuidimit, ZR Pejë, ZR Prizren, ZR Gjilan.

NENI II: QËLLIMI I KONTRATËS

II.1 Titulli i kontratës i dhënie nga autoriteti kontraktues: Furnizim me kuti arkive (gjerësia 10cm), sasia 32500 kuti, doreza medicinale - sasia 150 kuti (me nga 100 copë) dhe maska mbrojtëse nga pluhuri - 100 kuti (me nga 100 copë).

II.2 Lloji i kontratës dhe lokacioni i dorëzimit:

Furnizim me material për Arkiv- kuti arkivi, maska dhe doreza, për ZR Pejë, ZR Prizren, ZR Gjilan. Lokacioni i dorëzimit është në AKP, ZQ Prishtinë - Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, 10.000 Prishtinë.

NENI III: KËRKESAT të cilat duhet të përmbushen nga OPERATORET EKONOMIK

IV.1 AFATI KOHOR PËR KËRKESAT E INFORMACIONEVE SHITESË OSE SQARUESE

IV.2 KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS

Oferta e përgjegjshme me çmim më të ulët

IV.2 Afati kohor për pranimin e tenderëve: më së voni më 31 Mars 2023 koha: 14:00.

IV.3 Takimi për hapjen e tenderëve:

Data: 31 Mars 2023 **Koha:** 14:30:00 **Vendi:** Objektivin e AKP-së, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, 10.000 Prishtinë

- Tenderuesit fitues dhe apo/eliminues do të njoftohen përmes emailit
- Ofertat duhet të jenë në zarf të mbyllur dhe të vulosura. Shikoni me kujdes kushtet të cilat duhet të plotësoni.

Kërkesa për dosjen e tenderit: Dosja e tenderit mund të shkarkohet në webfaqen www.pak-ks.org.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "A&P" L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810508947 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "A&P" L.L.C. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810508947 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "A&P" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810508947 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

POZIV ZA PODNOŠENJE PONUDA SNABDEVANJE

U skladu sa unutrašnjim uputstvom za nabavku br. 1/2009, za Likvidacione organe

Datum: 29.03.2023. godine

I: UGOVORNO TELO: Kosovska agencija za privatizaciju, Likvidacioni organ, RK Peć, RK Prizren, RK Gnjilane.

ČLAN II: SVRHA UGOVORA

II.1 Naziv ugovora dat od strane ugovornog tela: Snabdevanje arhivskim kutijama (širine 10 cm), količina 32500 kutija, medicinske rukavice - količina 150 kutija (sa po 100 komada) i maske za zaštitu od prašine -100 kutija (sa po 100 komada).

II.2 Vrsta ugovora i mesto isporuke:

Snabdevanje materijalom za arhivu - arhivske kutije, maske i rukavice, za RK Pejë, RK Prizren, RK Gnjilane. Mesto isporuke je u KAP, GS Prishtina - Ul. "Dritan Hoxha" br. 55, Lakrishtë, 10.000 Prishtina.

ČLAN III: ZAHTEVE koje treba da ispune PRIVREDNI SUBJEKTI

IV.1 ROK ZA ZAHTEVANJE DODATNIH INFORMACIJA ILI POJAŠNJENJA

IV.2 KRITERIJUMI ZA DODELU UGOVORA

Odogovarajuća ponuda sa najnižom cenom

IV.2 Rok za prijem tendera: najkasnije do 31. marta 2023. godine Vreme: 14:00 časova.

IV.3 Sastanak za otvaranje tendera:

Datum: 31. mart 2023. **Vreme:** 14:30:00 **Mesto:** Objekat KAP-a, Ul. "Dritan Hoxha" br. 55, Lakrishtë, 10.000 Prishtina

- Pobednički i/ili eliminisani ponuđači biće obavesteni preko imejla
- Ponude treba da budu u zatvorenoj i zapečaćenoj kovrti. Pažljivo pogledajte uslove koje treba da ispunite.

Zahtev za tenderski dosije: Tenderski dosije možete preuzeti sa vebstranice www.pak-ks.org.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues